FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 173

Tiranë – E mërkurë, 21 shtator 2016

PËRMBAJTJA

		Faqe
Udhëzim i ministrit të Arsimit dhe Sportit dhe i ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë nr. 16, datë 3.8.2016	Për vitin shkollor 2016–2017 në sistemin arsimor parauniversitar.....	20479
Udhëzim i ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 17, datë 3.8.2016	Për procedurat dhe kriteret për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë, të diplomave, certifikatave, gradave shkencore dhe titujve akademikë, të lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara, jashtë vendit.....	20495
Udhëzim i ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 18, datë 11.8.2016	Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit të kandidatëve nga Republika e Kosovës, kandidatëve me origjinë shqiptare nga Maqedonia, Mali i Zi, Presheva, Medvegja dhe Bujanovci, si dhe kandidatëve me statusin e të verbrit, invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik, e jetimit, si dhe romët dhe egjiptianët, në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2016–2017”.....	20501
Udhëzim i ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 19, datë 11.8.2016	Për zhvillimin e provimeve kombëtare të arsimit bazë 2016, sesioni i dytë.....	20506
Udhëzim i ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 20, datë 11.8.2016	Për zhvillimin e provimeve të maturës shtetërore 2016, sesioni i dytë.....	20507
Udhëzim i ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 21, datë 18.8.2016	Për organizimin dhe funksionimin e gjimnazit me kohë të pjesshme.....	20509

UDHËZIM
Nr. 16, datë 3.8.2016

PËR VITIN SHKOLLOR 2016–2017
NË SISTEMIN ARSIMOR
PARAUNIVERSITAR

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të germës "a", të pikës 2, të nenit 26, të ligjit nr. 69/2012, datë 21.6.2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 8872, datë 29.3.2002, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

UDHËZOJMË:

KREU I
STRUKTURA E VITIT SHKOLLOR 2016–2017

1. ARSIMI BAZË:

a) Mësimi

Mësimi fillon më 13 shtator 2016 dhe mbaron më 9 qershor 2017.

b) Pushime

Fillojnë më 24 dhjetor 2016 dhe mbarojnë më 3 janar 2017.

Fillojnë më 31 mars 2017 dhe mbarojnë më 2 prill 2017.

c) Provime

Provimet e lirimit zhvillohen në periudhën 10–30 qershor 2017.

2. ARSIMI I MESËM I LARTË

a) GJIMNAZI ME KOHË TË PLOTË DHE ARSIMI I ORIENTUAR

a) Mësimi

Mësimi fillon më 13 shtator 2016 dhe mbaron më 16 qershor 2017.

Për maturat, viti shkollor fillon më 13 shtator 2016 dhe mbaron më 31 maj 2017.

b) Pushime

Fillojnë më 24 dhjetor 2016 dhe mbarojnë më 3 janar 2017.

a) Provime

Provimet e Maturës Shtetërore zhvillohen në periudhën 1–30 qershor 2017.

b) ARSIMI PROFESIONAL

a) Mësimi

Mësimi fillon më 13 shtator 2016 dhe përfundon:

a.1) Më 16 qershor 2017, për nxënësit e klasave të 10-ta (për të gjitha strukturat), për nxënësit e klasave të 12-ta (për strukturën 2+2) dhe për nxënësit e klasave të 11-ta dhe të 12-ta (për strukturën bllok 4-vjeçare).

a.2) Më 2 qershor 2017, për nxënësit e klasave të 11-ta dhe të 12-ta (struktura 2+1+1) dhe për nxënësit e klasave të 11-ta (struktura 2+2).

a.3) Më 23 maj 2017, për të gjithë nxënësit maturantë.

b) Pushime:

Fillojnë më 24 dhjetor 2016 dhe mbarojnë më 3 janar 2017.

c) Provime

c.1) Provimet përfundimtare të nivelit I dhe II zhvillohen në periudhën 5–16 qershor 2017.

c.2) Provimet përfundimtare të nivelit III zhvillohen në periudhën 24–30 maj 2017.

c.3) Provimet e Maturës Shtetërore zhvillohen në periudhën 1–30 qershor 2017.

3. MATURA SHTETËRORE

Rregullorja e zhvillimit të provimeve të Maturës Shtetërore 2017 dhe udhëzimet përkatëse do të miratohen nga ministri.

KREU II
PLANET MËSIMORE DHE BAZA LIGJORE

1. ARSIMI BAZË

Për shkollat e arsimit bazë do të zbatohen planet mësimore si më poshtë:

a) Plani mësimor i klasave III–V dhe VIII–IX

Nr.	Lëndët	III	IV	V	VIII	IX
1	Gjuhë amtare (Gjuhë shqipe)	6	5	5	5	5
2	Gjuhë e huaj	2	2	2	3	3
3	Matematikë	5	4	4	4	4
4	Dituri natyre	2	3	2	-	-
5	Fizikë	-	-	-	2	2
6	Kimi	-	-	-	1	2
7	Biologji dhe edukim shëndetësor	-	-	-	2	2
8	Vendlindje	-	-	2	-	-
9	Histori	-	1	-	2	2
10	Gjeografi	-	-	-	2	2
11	Edukatë shoqërore	1	1	1	1	1
12	Edukim figurativ	1	1	1	1	-
13	Edukim muzikor	1	1	1	2	2
14	Aftësim teknologjik	1	1	1	-	-
15	Edukim fizik	3	3	3	3	3
16	Informatikë	-	-	-	1	1
17	Veprimtari jashtëkurrikulare dhe lëndë me zgjedhje	-	1	1	-	-
	Gjithsej orë/javë:	**22**	**23**	**23**	**29**	**29**

b) Plani mësimor i klasave I–II dhe VI–VII

Nr.	FUSHA/LËNDËT	KLASAT			
		I	II	VI	VII
1	**GJUHËT DHE KOMUNIKIMI**	**8**	**8**	**8**	**8**
1.1	Gjuhë shqipe	8	8	5	5
1.2	Gjuhë e huaj e parë	0	0	3	3
2	**MATEMATIKË**	**4**	**4**	**4**	**4**
3	**SHKENCAT E NATYRËS**	**1**	**1**	**2**	**4**
3.1	Dituri natyre	1	1	-	-
3.2	Fizikë	-	-	1	2
3.3	Kimi	-	-	-	-
3.4	Biologji	-	-	1	2
4	**SHOQËRIA DHE MJEDISI**	**1**	**1**	**3**	**5**
4.1	Edukim për shoqërinë	1	1	-	-
4.2	Qytetari	-	-	1	1
4.3	Histori	-	-	1	2
4.4	Gjeografi	-	-	1	2
5	**ARTE**	**2**	**2.5**	**3**	**2**
5.1	Muzikë	1	1	1	1
5.2	Art pamor	1	1	1	1
5.3	Kërcim	-	0.5	-	-
5.4	Teatër	-	-	1	-
6	**EDUKIMI FIZIK, SPORTI DHE SHËNDETI**	**3**	**3**	**3**	**3**
7	**TEKNOLOGJI DHE TIK**	**0**	**0**	**2**	**1**
7.1	TIK	-	-	1	1
7.2	Aftësimi teknologjik praktik	-	-	1	-
8	**KURRIKULA ME ZGJEDHJE**	**1**	**1**	**2**	**2**
	Gjithsej orë/javë	**20**	**20/21**	**27**	**29**

c) Plani mësimor i shkollës speciale "Luigj Gurakuqi"

Nr.	Lëndët	KLASAT								
		I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX
1	Gjuhë amtare: Abetare, komunikim, elemente shkrimi, ushtrim të foluri	10	10	10	10	10	4	4	4	4
2	Matematikë dhe zhvillim logjik	5	5	5	5	5	3	3	3	3
3	Punë dore dhe art	3	3	3	3	3	2	2	2	2
4	Edukim shoqëror	2	2	2	2	2	2	2	2	2
5	Edukim shëndetësor dhe vetëshërbim	2	2	2	2	2	2	2	2	2
6	Edukim fizik	3	3	3	3	3	3	3	3	3
7	Edukim muzikor dhe muzikoterapi	2	2	2	2	2	2	2	2	2
8	Terapi të foluri me seanca individuale	2	2	2	2	2	2	2	2	2
9	Orientim dhe njohje me mjedisin	1	1	1	1	1	1	1	1	1
10	Mësim pune	-	-	-	-	-	9	9	9	9
	Gjithsej orë/javë:	**30**	**30**	**30**	**30**	**30**	**30**	**30**	**30**	**30**

d) Plani mësimor i shkollave të pakicave kombëtare, klasat III–V dhe VIII–IX

Nr.	Lëndët	KLASAT				
		III	IV	V	VIII	IX
1	Gjuhë amtare (greke/maqedonase)	5	4	4	4	3
2	Gjuhë shqipe dhe Lexim letrar	5	5	5	4	4
3	Gjuhë e huaj	-	-	-	2	2
4	Matematikë	5	4	4	4	4
5	Dituri natyre	2	3	2	-	-
6	Fizikë	-	-	-	2	2
7	Kimi	-	-	-	1	2
8	Biologji dhe edukim shëndetësor	-	-	-	2	2
9	Vendlindje	-	-	2	-	-
10	Histori	-	1	-	2	2
11	Gjeografi	-	-	-	2	2
12	Histori amtare (greke/maqedonase)	-	-	-	-	1
13	Gjeografi amtare (greke/maqedonase)	-	-	-	1	-
14	Edukatë shoqërore	1	1	1	1	1
15	Edukim figurativ	1	1	1	1	-
16	Edukim muzikor	1	1	1	1	2
17	Aftësim teknologjik	1	1	1	-	-
18	Edukim fizik	3	3	3	3	3
19	Informatikë	-	-	-	1	1
	Gjithsej	**24**	**24**	**24**	**31**	**31**

e) Plani mësimor i shkollave të pakicave kombëtare, klasat I–II dhe VI–VII

Nr.	FUSHAT/LËNDËT	Klasat			
		I	II	VI	VII
1	**GJUHËT DHE KOMUNIKIMI**	**8/9**	**11**	**10**	**11**
1.1	Gjuhë amtare (greke/maqedonase)	8/7	6	4	4
1.2	Gjuhë Shqipe	0/2	5	4	5
1.3	Gjuhë e Huaj	-	-	2	2
2	**MATEMATIKË**	**4**	**4**	**4**	**4**
3	**SHKENCAT E NATYRËS**	**1**	**1**	**2**	**4**
3.1	Dituri natyre	1	1	-	-
3.2	Fizikë	-	-	1	2
3.3	Kimi	-	-	-	-
3.4	Biologji	-	-	1	2
4	**SHOQËRIA DHE MJEDISI**	**1**	**1**	**3**	**5**
4.1	Gjeografi	-	**-**	**1**	**2**
4.2	Edukim për shoqërinë	1	1	-	-
4.3	Qytetari	-	-	1	1
4.4	Histori	-	-	1	2
4.5	Histori amtare (greke/maqedonase)	-	-	-	-
4.6	Gjeografi amtare (greke/maqedonase)	-	-	-	-
5	**ARTE**	**2**	**2/3**	**3**	**2**
5.1	Muzikë	1	1	1	1
5.2	Art pamor	1	1	1	1
5.3	Kërcim	-	0/1	-	-
5.4	Teatër	-	-	1	-
6	**EDUKIMI FIZIK, SPORTI DHE SHËNDETI**	**2**	**2**	**2**	**2**
7	**TEKNOLOGJI DHE TIK**	**-**	**-**	**2**	**1**
7.1	TIK	-	-	1	1
7.2	Aftësim teknologjik praktik	-	-	1	-
8	**KURRIKULA ME ZGJEDHJE**	**1**	**1**	**-**	**-**
	SHUMA (orë/javë)	**19/20**	**22/23**	**26**	**29**

f) Plani mësimor për arsimin bazë, për shkollën koreografike, miratuar me nr. 5716 prot., datë 26.5.2016.

g) Plani mësimor i arsimit bazë, për shkollat artistike miratuar me nr. 5419 prot., datë 26.5.2016.

2. ARSIMI I MESËM I LARTË

Për shkollat e arsimit të mesëm të lartë, gjimnaz, arsimi i mesëm i orientuar dhe arsimi i mesëm profesional, do të zbatohen planet mësimore si më poshtë:

a) Plani mësimor i gjimnazit, klasat XI–XII, miratuar me nr. 91 prot., datë 11.1.2010;

b) Plani mësimor i gjimnazit, klasa X, miratuar me nr. 1184/15 prot., datë 25.2.2016.

Planet mësimore për arsimin e mesëm të orientuar do të jenë si më poshtë:

- Plani mësimor për arsimin e mesëm të orientuar (artistike), miratuar me nr. 5420 prot., datë 26.5.2016.

- Plani mësimor për arsimin e mesëm të orientuar (artistike), miratuar me nr. 5421 prot., datë 26.5.2016.

- Plani mësimor për arsimin e mesëm të orientuar (artistike), miratuar me nr. 5422 prot., datë 26.5.2016.

- Plani mësimor për arsimin e mesëm të orientuar (artistike), miratuar me nr. 5422/1 prot., datë 26.5.2016.

- Plani mësimor për arsimin e mesëm të orientuar (sportive), miratuar me nr. 5418 prot., datë 26.5.2016.

- Plani mësimor për arsimin e mesëm të orientuar (sportive), miratuar me nr. 5418/1 prot., datë 26.5.2016.

- Plani mësimor për arsimin e mesëm të orientuar për shkollën koreografike, miratuar me nr. 5417 prot., datë 26.5.2016.

- Plani mësimor arsimi i mesëm i orientuar (gjuhët e huaja), miratuar me nr. 5415 prot., datë 26.5.2016.

3. GJIMNAZI ME KOHË TË PJESSHME

Plani mësimor i gjimnazit me kohë të pjesshme, miratuar me nr. 7380, datë 20.7.2016

BAZA LIGJORE E VEPRIMTARISË SË INSTITUCIONEVE ARSIMORE

Veprimtaria e institucioneve të arsimit parauniversitar të realizohet në zbatim të ligjeve, vendimeve të Këshillit të Ministrave dhe urdhrave e udhëzimeve në fuqi, të nxjerrë nga ministri i Arsimit dhe Sportit, si më poshtë:

- Ligji nr. 69/2012, datë 21.6.2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

- Dispozitat Normative (DN) për sistemin arsimor parauniversitar, 2013, të ndryshuara me urdhrin nr. 169, datë 8.5.2014, "Për disa ndryshime në dispozitat normative në sistemin arsimor parauniversitar".

- Kodi i Etikës së Mësuesit në arsimin parauniversitar publik dhe privat, miratuar nga ministri i Arsimit dhe Sportit, më 30 nëntor 2013.

- Ligji nr. 10221, datë 4.2.2010, "Për mbrojtjen nga diskriminimi".

- VKM nr. 707, datë 28.8.2015, "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 107, datë 10.2.2010 të Këshillit të Ministrave, "Për botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore të sistemit të arsimit parauniversitar", i ndryshuar.

- VKM nr. 682, datë 29.7.2015, "Për përdorimin e fondeve publike për transportimin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit", i ndryshuar.

- Udhëzimi i përbashkët i ministrit të Arsimit dhe Sportit dhe ministrit të Financave nr. 33, datë 10.9.2015, "Për një shtesë në udhëzimin e përbashkët nr. 51, datë 20.9.2013, "Për procedurat e përdorimit të fondeve të buxhetit të shtetit për botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve të arsimit parauniversitar".

- Udhëzimi i përbashkët i ministrit të Arsimit dhe Sportit dhe ministrit të Financave nr. 35, datë 14.9.2015, "Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin e përbashkët nr. 51, datë 20.9.2013 të ministrit të Arsimit dhe ministrit të Financave, "Për procedurat e përdorimit të fondeve të buxhetit të shtetit për botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve të arsimit parauniversitar".

- Udhëzimi i përbashkët i ministrit të Arsimit dhe Sportit dhe ministrit të Financave nr. 51, datë 20.9.2013, "Për procedurat e përdorimit të fondeve të buxhetit të shtetit për botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve të arsimit parauniversitar".

- Urdhri nr. 344, datë 19.8.2013, "Për ngritjen e njësisë së shërbimit psikosocial".

- Urdhri nr. 477, datë 6.12.2014, "Për miratimin e kartës së performancës së shkollës dhe udhëzuesit përkatës".

- Urdhri nr. 195, datë 25.4.2016, "Për miratimin e dokumentit "Edukimi dhe formimi i mësuesve për gjithëpërfshirjen-Profili i mësuesit gjithë-përfshirës".

- Udhëzimi nr. 2, datë 5.2.2014, "Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të mësuesve".

- Udhëzimi nr. 5, datë 25.2.2013, "Për standardet e përgjithshme të mësuesit".

- Udhëzimi nr. 38, datë 7.10.2014, "Për kriteret e mësuesit ndihmës për nxënësit me aftësi të kufizuara në institucionet publike të arsimit parauniversitar".

- Udhëzimi nr. 21, datë 8.8.2014, "Për rritjen e ndjekjes së arsimit parashkollor nga fëmijët romë".

- Udhëzimi nr. 21, datë 9.7.2015, "Për procedurat e transferimit të nxënësve nga një nivel /drejtim i arsimit profesional në gjimnaz".

- Udhëzim i ministrit të Arsimit nr. 34, datë 11.9.2015, "Për vlerësimin e nxënësve për kurrikulën me kompetenca, në arsimin bazë".

- Udhëzimi nr. 12, datë 27.4.2015, "Për mbledhjen, përpunimin dhe mbrojtjen e të dhënave personale të punonjësve arsimorë të institucioneve arsimore parauniversitare dhe të nxënësve, si dhe për përmbajtjen e dosjeve të tyre personale".

- Udhëzimi nr. 21, datë 23.7.2010, "Për normat e punës mësimore-edukative dhe numrin e nxënësve për klasë në institucionet e arsimit parauniversitar", i ndryshuar me udhëzimin nr. 44, datë 15.10.2014, "Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin e MASH-it nr. 21, datë 23.7.2010, "Për normat e punës mësimore-edukative dhe numrin e nxënësve për klasë në institucionet e arsimit

parauniversitar".

- Udhëzimi nr. 15, datë 12.7.2013, "Për procedurat e posaçme për shqyrtimin e kërkesave për licencë të institucioneve arsimore private dhe institucioneve arsimore plotësuese private parauniversitare".

- Udhëzimi nr. 23, datë 2.8.2013, "Për ndjekjen e gjimnazit me kohë të pjesshme".

- Udhëzimi nr. 24, datë 2.8.2013, "Për certifikimin e hartuesve të testeve dhe vlerësuesve në provimet kombëtare".

- Udhëzimi nr. 25, datë 2.8.2013, "Për organizmin dhe funksionimin e qeverisë së nxënësve".

- Udhëzimi nr. 26, datë 2.8.2013, "Për përcaktimin e detyrave dhe funksioneve të këshillit të mësuesve".

- Udhëzimi nr. 27, datë 2.8.2013, "Për bordin e institucionit arsimor".

- Udhëzimi nr. 28, datë 2.8.2013, "Për pajisjen e nxënësve me dëftesë klase".

- Udhëzimi nr. 29, datë 2.8.2013, "Për procedurat e ndjekjes së arsimit bazë me kohë të pjesshme".

- Udhëzimi nr. 30, datë 2.8.2013, "Për rregulloren tip të institucioneve arsimore".

- Udhëzimi nr. 31, datë 2.8.2013, "Për procedurat e ndjekjes së arsimit bazë për nxënësit që nuk kanë ndjekur të paktën dy klasa të arsimit bazë".

- Udhëzimi nr. 34, datë 2.8.2013, "Për planifikimin e fondeve buxhetore dhe ndjekjen e procedurave të prokurimit për blerjen e librave të institucioneve arsimore publike".

- Udhëzimi nr. 36, datë 13.8.2013, "Për procedurat për arsimimin e fëmijëve të ngujuar".

- Udhëzimi nr. 38, datë 13.8.2013, "Për arsimin e individëve të moshës shkollore në institucionet e përkujdesjes shoqërore".

- Udhëzimi nr. 43, 21.8.2013, "Për planifikimin e fondeve buxhetore, prokurimin dhe blerjen e mjeteve mësimore për institucionet arsimore publike".

- Udhëzimi nr. 44, datë 21.8.2013, "Për përcaktimin e kritereve dhe procedurave të njëvlershmërisë së dëftesave dhe diplomave të nxënësve të arsimit parauniversitar të ardhur nga jashtë vendit".

- VKM-ja nr. 407, datë 1.6.2016, "Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimit të ciklit të parë dhe programet e integruara të ciklit të dytë, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2016–2017".

- Udhëzimi katërministror midis Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë (MMSR), Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (MAS), Ministrisë së Punëve të Jashtme (MPJ) nr. 10, datë 25.2.2015, "Për mënyrat, format e bashkëpunimit dhe procedurat e ndërhyrjes në ndihmë të fëmijëve në rrezik për institucionet dhe strukturat kryesore përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijës".

- Udhëzimi nr. 38, datë 6.10.2015, "Për procedurat e lëvizjes paralele, emërimit dhe largimit nga puna të mësuesit në institucionet publike të sistemit arsimor parauniversitar".

- Udhëzimi nr. 57, datë 12.11.2013, "Për procedurat e emërimit dhe të shkarkimit të drejtorit të institucionit arsimor publik".

- Udhëzimi nr. 58, datë 12.11.2013, "Për procedurat e emërimit dhe të shkarkimit të nëndrejtorit të institucionit arsimor publik".

- Udhëzimi nr. 42, datë 15.10.2014, "Për arsimimin e individëve të moshës shkollore në institucionet e paraburgimit, të vuajtjes së dënimit".

- Udhëzimi nr. 14, datë 12.5.2015, "Për përcaktimin e kritereve dhe procedurave për pranimin në shkollat e arsimit të orientuar".

- Rregullorja nr. 336, datë 14.7.2011, "Për organizmin dhe zhvillimin e praktikave profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit".

- Standardet e drejtorit (hartuar nga Instituti i Zhvillimit të Arsimit), miratuar me shkresën nr. 4296 prot., datë 27.8.2013.

- Standardet e Shkollës si Qendër Komunitare, miratuar me shkresën nr. 1794, datë 13.3.2013 dhe udhëzuesi për shkollat qendra komunitare, tetor 2014.

- Urdhri nr. 477, datë 5.12.2014, "Për miratimin e Kartës së Performancës së Shkollës dhe udhëzuesit për Kartën e Performancës së Shkollës".

KREU III
VEPRIMTARIA NË INSTITUCIONET ARSIMORE

I. ARSIMI PARASHKOLLOR

1. Kurrikula e arsimit parashkollor të bazohet në "Standardet e zhvillimit dhe të të nxënit për fëmijët 3–6-vjeçare" dhe programet e arsimit parashkollor për çdo grup.

2. Drejtoritë arsimore rajonale/zyrat arsimore (DAR/ZA-të), drejtuesit dhe mësuesit e kopshteve publike të ndjekin me përparësi:

a) regjistrimin në klasën përgatitore (grupi i tretë) të fëmijëve 5-vjeçarë që nuk kanë ndjekur më parë kopshtin;

b) regjistrimin në kopsht të fëmijëve me nevoja të veçanta (nga familjet në nevojë, rome, egjiptiane dhe fëmijët me aftësi të kufizuara);

c) ngritjen dhe funksionimin e komisioneve për fëmijët me aftësi të kufizuara, në ato institucione ku ka fëmijë të tillë;

d) vijimin pa ndërprerje të aktivitetit të kopshteve me ose pa ushqim gjatë gjithë vitit kalendarik.

3. Mësuesit e kopshteve të hartojnë dhe të zbatojnë programe individuale edukative për fëmijët me nevoja të veçanta, në bashkëpunim me prindërit e fëmijëve.

4. Fëmijët që përfundojnë njërin nga tri grupet dhe kanë moshën për të ndjekur klasën e parë, të pajisen me vërtetimin e ndjekjes së kopshtit për grupin përkatës, të nënshkruar nga drejtuesi i kopshtit.

5. Në çdo kopsht të ngrihen sipas legjislacionit në fuqi, bordi, këshilli i prindërve, këshilli i mësuesve dhe komisioni i etikës e sjelljes.

6. Këshillat e mësuesve dhe rrjetet profesionale të trajtojnë me përparësi këto tema:

a) standardet e zhvillimit dhe të të nxënit të fëmijëve 3–6 vjeç;

b) portofoli i të nxënit;

c) vlerësimi i fëmijëve një herë në tre muaj, sipas fushave të zhvillimit dhe të të nxënit;

d) bashkëpunimi me prindërit e fëmijëve me qëllim që veprimtaritë që zhvillohen në kopsht dhe në shtëpi, të plotësojnë dhe të përforcojnë njëratjetrën.

II. ARSIMI BAZË

Procesi mësimor në arsimin bazë të zhvillohet sipas planeve dhe programeve mësimore në fuqi dhe kurrikulës së miratuar.

1. DAR/ZA-të ndjekin me përparësi:

a) Zbatimin e kurrikulës së re në klasën e parë, të dytë, të gjashtë dhe të shtatë.

b) Pilotimin e kurrikulës së re në klasën e tretë dhe të tetë.

c) Ngritjen dhe funksionimin e komisioneve multidisiplinare për fëmijët me aftësi të kufizuara, ndërsa në shkollat (jospeciale) ngritjen dhe funksionimin e komisioneve për këta fëmijë (në ato shkolla ku ka fëmijë me aftësi të kufizuara), bazuar në Dispozitat Normative 2013, të ndryshuara.

d) Caktimin e mësuesit ndihmës për fëmijët me aftësi të kufizuara, në ato shkolla ku ka fëmijë të tillë, sipas rekomandimit të dhënë nga komisioni multidisiplinar pranë DAR/ZA.

e) Pjesëmarrjen aktive të përfaqësuesve të tyre në njësitë për mbrojtjen e fëmijëve, të ngritura në nivel bashkie dhe në nivel qarku.

f) Plotësimin e nevojave dhe kërkesave për arsimim në gjuhën amtare të pakicave kombëtare, në përputhje me konventën përkatëse dhe legjislacionin e BE-së.

g) Regjistrimin me përparësi në shkollë të fëmijëve nga shtresat në nevojë, romë, egjiptianë, me aftësi të kufizuara, të kthyer nga emigracioni, si dhe të fëmijëve viktima apo viktima të mundshme të trafikut të qenieve njerëzore.

h) Krijimin e rrjetit profesional të mësuesve për zbatimin e kurrikulës së re.

i) Sigurimin e ndjekjes së arsimit bazë me kohë të pjesshme.

j) Koordinimin e veprimeve për realizimin e të gjithë aktiviteteve për mbrojtjen e fëmijëve në internet.

k) Koordinimin e veprimeve për evidentimin e braktisjes shkollore në nivelet përkatëse të arsimit bazë.

l) Koordinimin e veprimeve për gjenerimin e të dhënave në sistemin SMIA për arsimin parauniversitar.

2. Shkollat e arsimit bazë të ndjekin me përparësi:

a) Bashkëpunimin me bordin, me këshillin e prindërve të shkollës dhe atij të klasës, me qeverinë e nxënësve, me njësinë vendore për mbrojtjen e fëmijës dhe me organizata jofitimprurëse.

b) Sigurimin e regjistrimit të nxënësve që i përkasin zonës së shkollës, si dhe ruajtjen e një numri të balancuar të nxënësve për klasë mes shkollave të një zone.

c) Regjistrimin me përparësi të fëmijëve sipas përcaktimit të pikës 1/g më sipër.

d) Zbatimin e udhëzimit nr. 31, datë 2.8.2013, "Për procedurat e ndjekjes së arsimit bazë për nxënësit që nuk kanë ndjekur të paktën dy klasa të arsimit bazë".

3. Mësuesit e shkollave të arsimit bazë (jospeciale), sipas rekomandimit të komisionit multidisiplinar të DAR/ZA-së, të hartojnë dhe të zbatojnë programe individuale edukative për fëmijët me aftësi të kufizuara, në bashkëpunim me prindërit e këtyre fëmijëve.

4. Nxënësit e klasave I–III të marrin vlerësim përshkrues në periudha tremujore, tri herë në vit, që përafërsisht bien në muajt dhjetor, mars dhe qershor. Vlerësimi përmbledhës të realizohet një herë në vit, pas realizimit të vlerësimit të tretë përshkrues. Vlerësimi përshkrues, që bëhet në regjistër, me kode nga 1–5, të realizohet mbi bazën e shënimeve periodike që mësuesi mban për çdo nxënës të klasës. Në ato linja, orët e të cilave nuk janë zhvilluar ende, mësuesi të bëjë në fund të faqes së regjistrit, shënimin: "Orët që i përkasin kësaj linje, nuk janë zhvilluar ende".

a) Një herë në tre muaj, mësuesi t'i japë prindit informacion me shkrim për përparimin e fëmijës për çdo lëndë. Në vlerësimin përshkrues të bëhet edhe një përshkrim i cilësive individuale të nxënësit, të aftësive bashkëpunuese dhe bashkëvepruese me nxënësit e tjerë në realizimin e detyrave dhe punimeve të përbashkëta.

b) Në fund të vitit shkollor të bëhet vlerësimi përmbledhës, i cili përcakton nivelin e arritjeve të secilit nxënës, si dhe vlerësimin vjetor për çdo lëndë.

5. Në dëftesë të bëhet vlerësimi vjetor i arritjeve të nxënësit, i shprehur me emërtimin e plotë të shkallëve të vlerësimit, ku për secilën lëndë nxënësi të marrë njërin prej vlerësimeve: "Arritje të pakënaqshme", "Arritje që kanë nevojë për përmirësim", "Arritje të kënaqshme", "Arritje shumë të kënaqshme" dhe "Arritje të shkëlqyera".

6. Në amzën e shkollës, vlerësimi të bëhet me shkurtime të emërtimeve të shkallëve të vlerësimit. Për "Arritje të pakënaqshme", të shkruhet APK; për "Arritje që kanë nevojë për përmirësim", të shkruhet ANP; për "Arritje të kënaqshme", të shkruhet AK; për "Arritje shumë të kënaqshme", të shkruhet ASHK dhe për "Arritje të shkëlqyera", të shkruhet ASH.

7. Drejtoritë e shkollave dhe mësuesit të organizojnë përkujdesje të posaçme për nxënësit me vështirësi relative në të nxënë, sipas neneve të Dispozitave Normative, të ndryshuara.

8. DAR/ZA-të dhe drejtoritë e shkollave të ndjekin me përparësi mësimin e gjuhëve të huaja:

a) Në arsimin fillor

Mësimi i gjuhës së huaj të parë të fillojë në klasën III dhe të sigurohet vijimësia e gjuhës së huaj për klasat e ndërmjetme të arsimit bazë. Në klasat III pilot do të zbatohet kurrikula e re me bazë kompetencën. Për herë të parë në klasat pilot nxënësit mund të zgjedhin edhe gjuhën gjermane si gjuhë të huaj të parë.

DAR/ZA-të dhe drejtoritë e shkollave të respektojnë parimin e shumëgjuhësisë në shkolla dhe të planifikojnë, sipas angazhimeve dypalëshe, hapjen e klasave të gjuhës së huaj në klasën III të arsimit fillor, sipas ndarjes: 10% e nxënësve të zhvillojnë gjuhën italiane; 30% e nxënësve të zhvillojnë gjuhën frënge dhe pjesa tjetër (60%) të zhvillojnë gjuhën angleze ose gjermane. Planifikimi të realizohet duke pasur parasysh stafin mësimdhënës dhe strukturën e shkollës.

Shkollat të mos planifikojnë gjuhë të huaj të dytë për klasat III, IV, V të arsimit fillor.

b) Për nxënësit që nuk kanë zhvilluar asnjëherë gjuhë të huaja

Për të gjithë nxënësit e klasës IX të sigurohet zhvillimi i mësimit të gjuhës e huaj, në mënyrë që të gjithë nxënësit, pa përjashtim, të jenë të përgatitur për të dhënë provimin e gjuhës së huaj në provimet e lirimit 2017.

c) Për sigurimin e vijimësisë së gjuhës së huaj

DAR/ZA-të dhe drejtoritë e shkollave të sigurojnë edhe vijimësinë e gjuhës së huaj të dytë të nisur në klasën VI në mbështetje të planit të ri mësimor dhe vijimësinë për nxënësit të cilët janë në vijim të planit mësimor ekzistues. Edhe në rastet e transferimeve, të ruhet vijimësia e gjuhës së huaj të parë dhe të dytë (në shkollat që e aplikojnë) nga arsimi bazë në arsimin e mesëm të lartë.

d) Për zbatimin e memorandumeve dhe marrëveshjeve dypalëshe.

DAR/ZA-të vijojnë zbatimin e marrëveshjeve dhe memorandumeve si vijon:

i) Për gjuhën italiane do të vijohet të zbatohet Memorandumi i Mirëkuptimit për programin "Iliria", duke mundësuar që 10% e numrit të nxënësve që mësojnë gjuhë të huaj, të mësojnë gjuhën italiane, duke filluar nga klasa III e arsimit fillor deri në klasën XII. Planifikimi i shkollave që do të zhvillojnë gjuhën italiane, është kompetencë e DAR/ZA-ve dhe moszbatimi ngarkon me përgjegjësi DAR/ZA-të.

ii) Për gjuhën frënge do të vijohet të zbatohen angazhimet në kuadër të aderimit në Organizatën Botërore të Frankofonisë, duke mundësuar që 30% e nxënësve që mësojnë gjuhë të huaj, të mësojnë gjuhën frënge si gjuhë e huaj e parë nga klasa III e ciklit të ulët.

iii) DAR Elbasan, Durrës, Korçë, Shkodër dhe Tiranë, në shkollat e të cilave funksionojnë klasat mbështetëse për seksionet dygjuhëshe, të zbatojnë me rigorozitet hapjen e klasave mbështetëse në shkollat e përcaktuara në memorandume. Hapja e klasave mbështetëse të fillojë në klasën III të ciklit të ulët në zbatim të marrëveshjeve dhe memorandumeve përkatëse. Mosrespektimi i tyre ngarkon me përgjegjësi DAR/ZA-të dhe drejtoritë e shkollave përkatëse.

iv) Brenda datës 30 shtator 2016, DAR/ZA-të të raportojnë në DAPU (MAS) planifikimin për secilën gjuhë të huaj dhe realizimin e detyrave të mësipërme.

9. DAR/ZA-të që kanë shkolla ku do të zbatohet projekti "Mësime të shahut në shkollë", të marrin masa për zbatimin e angazhimeve, në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit midis Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Federatës Evropiane të Shahut dhe Federatës Shqiptare të Shahut.

10. Në zbatim të Memorandumit të Mirë-kuptimit ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe UNFPA, të konsiderohet përparësi programi: Edukimi Shëndetësor me fokus Aftësitë për Jetën dhe Edukimin Seksual. DAR/ZA-të dhe drejtoritë e shkollave të arsimit bazë, të lehtësojnë procesin e trajnimit të mësuesve të ciklit fillor, të lëndëve: Biologji, Edukim qytetar, Edukim fizik sport dhe shëndet.

11. Në zbatim të kontratës që MAS-i ka me Komisionin Evropian për implementimin e programit *e-Twinning*, program i *Erasmus Plus* për arsim dhe edukim, DAR/ZA të koordinojnë veprimet për angazhimin e shkollave, drejtuesve dhe mësuesve në aktivitetet që mundëson ky program.

III. ARSIMI I MESËM I LARTË

III.1 GJIMNAZET

DAR/ZA-ja të ndjekë me përparësi:

- zbatimin e kurrikulës së re në klasën e 10-të;
- zbatimin e kurrikulës digjitale në klasën e 10-të dhe të 11-të në 60 gjimnazet e përzgjedhura.

DAR/ZA-të, drejtoritë e gjimnazeve dhe mësuesit, krahas zbatimit cilësor të kurrikulës bërthamë dhe asaj me zgjedhje të detyruar, t'i kushtojnë vëmendje të posaçme hartimit dhe zbatimit cilësor të kurrikulës me zgjedhje të lirë, në përgjithësi, dhe të shërbimit komunitar, në veçanti.

Drejtoritë e gjimnazeve të informojnë nxënësit dhe prindërit e tyre për programet e reja të moduleve profesionale që ka hartuar IZHA-ja, në ndihmë të zbatimit të kurrikulës me zgjedhje të lirë dhe sipas kushteve të shkollës, të përfshijnë në zbatimin e kurrikulës me zgjedhje të lirë modulet profesionale:

- punime të mirëmbajtjes dhe të riparimit në banesa;
- etika e të veshurit dhe e arredimit;
- veprimtari në shërbimin e klientit;
- estetika dhe truku;
- veprimtari bujqësore;
- veprimtari ndihmëse në laborator;
- kujdesi për kafshët e shoqërimit;
- asistencë zyre;
- përpunim i produkteve ushqimore;
- punime të riparimit dhe mirëmbajtjes mekanike;
- pronësia intelektuale;
- arritje rinore (*Junior Achievement*);
- ju dhe biznesi;
- etj.

Materialet e plota për këto module gjenden në: www.izha.edu.al

Brenda muajit dhjetor 2016, DAR/ZA-të t'i dërgojnë Drejtorisë së Arsimit Parauniversitar (DAPU) në MAS, raportin vlerësues të zbatimit të kurrikulës me zgjedhje të lirë për tri vitet shkollore paraardhëse.

- Në vijim të zbatimit të marrëveshjes së MAS-it me Fondacionin Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim, edhe gjatë vitit shkollor 2016–2017, klasat XI dhe XII të shkollave të përzgjedhura në këtë projekt, të zhvillojnë programin "Arritje rinore" (*Junior*

Achievement) në kurrikulën me zgjedhje të lirë. DAR/ZA-të t'u mundësojnë zbatimin e këtij projekti të gjitha shkollave të përzgjedhura dhe të marrin masa që, të paktën dy klasa (një klasë e 11-të dhe një klasë e 12-të), të zgjedhin modulet e programit "Arritje rinore".

Në zbatim të Marrëveshjes së bashkëpunimit midis MAS-it dhe Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë (MMSR) me Këshillin Britanik e *Vodafone Foundation Albania*, të vijojë zbatimi i projektit të nisur. Përgjatë vitit shkollor 2016–2017, në klasat X, XI dhe XII të shkollave të përzgjedhura në këtë projekt, të zhvillohet programi "Edukimi nëpërmjet novacionit dhe teknologjisë", në kurrikulën me zgjedhje të lirë.

- Në zbatim të Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet MAS-it dhe UNFPA-së (Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim në Shqipëri), të konsiderohet përparësi programi; Edukimi Shëndetësor me fokus Aftësitë për Jetën dhe Edukimin seksual. DAR/ZA-të dhe drejtoritë e gjimnazeve, të lehtësojnë procesin e trajnimit të mësuesve të lëndës Biologji, Edukim qytetar, Edukim fizik sport dhe shëndet.

III.2 GJIMNAZET ME ORIENTIM GJUHË-SOR

1. Të punojnë me planin e ri mësimor nr. 5415 prot., datë 26.5.2016, duke filluar zbatimin në klasat X. Klasat e ndërmjetme të vijojnë të punojnë me planin mësimor aktual.

2. T'i zgjedhin vetë tekstet shkollore për lëndën e gjuhës së huaj, nëse ato të ofruara në katalogun 2016–2017 nuk përmbushin kërkesat kurrikulare të kësaj lënde.

3. Në lëndën e gjuhës së huaj të punohet me grupe në përputhje me udhëzimin nr. 21, datë 23.7.2010, "Për normat e punës mësimore-edukative dhe numrin e nxënësve për klasë në institucionet e arsimit parauniversitar", të ndryshuar.

4. Për vlerësimin e projekteve shkollore të zbatohen udhëzimet e dhëna në shkresën e MAS-it nr. 560/1 prot., datë 10.2.2014.

III.3 SEKSIONET DYGJUHËSHE SHKO-LLORE

1. Për seksionin dygjuhësh shqiptaro-francez, DAR Durrës, Elbasan, Korçë, Shkodër dhe Tiranë të punojnë për zbatimin e marrëveshjes nr. 6045 prot., datë 13.6.2016, midis MAS-it dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme (MPJ) dhe Zhvillimit Ndërkombëtar të Republikës së Francës mbi "Bashkëpunimin në fushën e arsimit dygjuhësh". Procedurat e zbatimit do të bëhen sipas shkresës nr. 6987, datë 11.7.2016, "Për procedurat e zbatimit të marrëveshjes për arsimin dygjuhësh".

2. Për seksionet dygjuhëshe shqiptaro-italiane dhe shqiptaro-gjermane, puna do të mbështetet në marrëveshjet e mëparshme, klasat XI dhe XII do të përfundojnë me planin mësimor sipas kësaj marrëveshjeje. Klasat X do të fillojnë të zbatojnë planin e ri mësimor për secilin seksion. Ky dokument gjendet në DAR-et dhe shkollat përkatëse.

3. Programet mësimore për lëndët që zhvillohen në gjuhë të huaj, si dhe tekstet shkollore të zgjedhura që zbatohen në seksionet dygjuhëshe, do të rishikohen nga palët përkatëse, nëse kanë ndryshime si pasojë e rishikimit të planeve mësimore dhe do të miratohen nga MAS-i para fillimit të vitit shkollor. Për lëndët në gjuhën shqipe të përdoren tekstet e ofruara në katalogun 2016–2017.

4. Drejtoritë e shkollave, për mbarëvajtjen e procesit mësimor, të sigurojnë bashkëpunim dhe bashkërendim midis ekipeve lëndore të seksioneve dygjuhëshe dhe atyre të gjimnazeve ku ato funksionojnë.

5. DAR-et të ndjekin me përparësi regjistrimin e nxënësve në seksionet dygjuhëshe.

III.4 ARSIMI PROFESIONAL

Zbatimi i skeletkurrikulave për drejtimet /profilet profesionale të nivelit III:

a) Për strukturën 2+1+1

Niveli III të ofrohet vetëm me drejtime mësimore, pra nxënësit që kanë përfunduar nivelin II (klasa XII) në një nga profilet mësimore të një drejtimi të caktuar, të vijojnë nivelin III (klasa XIII) vetëm në drejtimin mësimor përkatës. P.sh., nxënësit e profileve "Shërbime motorike" dhe "Shërbime xhenerike", klasa XII, të vijojnë shkollimin në drejtimin "Shërbime mjetesh transporti", klasa XIII. Kjo do të thotë që, nxënësit që përfunduan klasën XII, në profile të ndryshme të të njëjtit drejtim, mund të bashkohen në klasa të përbashkëta dhe të ndjekin drejtimin mësimor përkatës në klasën XIII.

b) Për strukturën 2+2

Niveli III të vazhdojë me profile mësimore. Nxënësit që kanë përfunduar nivelin I (klasa XI) në një nga drejtimet mësimore, mund të vijojnë nivelin

III (klasa XII–XIII) **vetëm** në një nga profilet mësimore të këtij drejtimi.

- Në kuadër të zbatimit të Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet AADF-së dhe Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, në të gjitha shkollat e mesme profesionale të zbatohet programi "*Junior Achievement*" (Arritje rinore). Të mundësohet hapja e të paktën një klase XII dhe një klase XIII (pa përjashtuar hapjen e klasave paralele për çdo nivel), të cilat do të ndjekin modulet "*Junior Achievement*" (në kuadër të lëndëve "Njohuri për biznesin I dhe II").

- Në kuadër të bashkëpunimit të MAS-it me Këshillin Britanik të mundësohet përdorimi i Modulit kurrikular "*English for Skills*" nga mësuesit e gjuhës angleze dhe nxënësit e klasave XIII të shkollave hoteleri-turizëm dhe të klasave XI–XII të shkollave teknike dhe elektrike, dega TIK.

- Shkollat ta përzgjedhin vetë mënyrën më optimale për të realizuar modulet e praktikave profesionale në të gjitha nivelet (të grupuara, të shpërndara, në mjediset e praktikave të shkollës, në biznese etj.).

- Për modulet praktike me zgjedhje të detyruar, përveç moduleve me zgjedhje që përmban skelet-kurrikula përkatëse, mund të hartohen/ propozohen edhe module të tjera, të cilat janë të rëndësishme për formimin e nxënësve, brenda numrit të orëve të parashikuara.

IV. ARSIMI PARAUNIVERSITAR PRIVAT

IV.1 Drejtoritë arsimore rajonale dhe zyrat arsimore

a) Të mbajnë kontakte të vazhdueshme me të gjitha institucionet e arsimit parauniversitar privat, t'i informojnë rregullisht për çdo ndryshim apo akt të ri ligjor dhe t'i ndihmojnë ato për realizimin e planeve dhe programeve mësimore, si dhe të veprimtarive jashtëshkollore rajonale e kombëtare.

b) Të kërkojnë raportim për të dhënat statistikore që lidhen me gjithë procesin mësimor, si: numrin e nxënësve të regjistruar në të gjitha nivelet e sistemit arsimor parauniversitar, braktisjen, kalueshmërinë etj.

IV.2 Institucionet arsimore parauniversitare private

a) Të raportojnë në DAR/ZA, në fillim të vitit shkollor, numrin e nxënësve dhe listën e mësuesve, sipas statistikave të miratuara, certifikatën e regjistrimit në organin tatimor dhe planin vjetor të shkollës sipas formatit të parashikuar në Dispozitat Normative 2013, të ndryshuara.

b) Të realizojnë detyrimet e tyre në përdorimin dhe ruajtjen e dokumentacionit (regjistra, amza, evidenca për lëvizjet e nxënësve, rregullore e brendshme e shkollës, dëftesa, kontrata me prindërit etj.), sipas udhëzimit nr. 15, datë 12.7.2013, "Për procedurat e posaçme për shqyrtimin e kërkesave për licencë të institucioneve arsimore private dhe institucioneve arsimore plotësuese private parauniversitare".

V. REGJISTRIMI I NXËNËSVE DHE PAJISJA ME TEKSTE SHKOLLORE

1. Regjistrimet e nxënësve në shkollat e arsimit parauniversitar të fillojnë në datën 1.9.2016 dhe të mbyllen në datën 9.9.2016 për arsimin bazë dhe arsimin e mesëm të lartë.

2. Drejtoritë e shkollave të afishojnë, në vend të dukshëm të shkollës, listën e teksteve shkollore, ku shënohen titulli, shtëpia botuese, çmimi i tekstit, për çdo klasë të shkollës, vendi ku do të blihen tekstet, si dhe periudha në të cilën do të shiten, sipas një grafiku për çdo klasë.

3. DAR/ZA-të, drejtuesit e shkollave dhe mësuesit të ndjekin me përgjegjësi procesin e shpërndarjes dhe shitjes së teksteve shkollore, në mënyrë që më 13 shtator të mos mbetet asnjë nxënës pa u pajisur me të gjitha tekstet shkollore që do t'i duhet të përdorë gjatë vitit shkollor.

4. DAR/ZA-të, drejtuesit e shkollave dhe mësuesit të ndjekin me përgjegjësi procesin e pajisjes me tekste shkollore falas, për të gjitha kategoritë e përcaktuara në VKM-në përkatëse.

5. DAR/ZA-të të njoftojnë zyrtarisht MAS-in për ecurinë e procesit të pajisjes së të gjithë nxënësve me tekste shkollore, me fokus kategoritë e veçanta, në përputhje me VKM-në përkatëse dhe me udhëzimin e përbashkët të MAS-it me Ministrinë e Financave.

6. DAR/ZA-të të ndjekin me përparësi dhe të koordinojnë procesin e hedhjes së të dhënave në shkolla, në platformën SMIA, sipas detyrimeve të përcaktuara të raportimeve statistikore.

VI. VLERËSIMI I DREJTORIT TË INSTITUCIONIT ARSIMOR DHE I MËSUESIT, PLANI VJETOR

1. Titullarët e DAR/ZA-ve dhe drejtorët e institucioneve arsimore të zbatojnë procedurat e vlerësimit përkatësisht të drejtorëve/mësuesve, siç parashikohet në nenet 60 dhe 74 të Dispozitave Normative 2013, të ndryshuara.

2. Plani vjetor i shkollës të hartohet e të miratohet sipas procedurave dhe formatit të përshkruar në nenin 67 të Dispozitave Normative 2013, të ndryshuara, dhe të jetë i zbatueshëm që në fillim të vitit shkollor. Në planin vjetor të shkollës të parashikohen veprimtari të caktuara, bazuar në aspekte të veçanta nga "Standardet e shkollës si qendër komunitare", të cilat shërbejnë në realizimin e objektivit/objektivave të planit vjetor.

VII. FUNKSIONIMI I ORGANIZMAVE NË INSTITUCIONET ARSIMORE

Në çdo institucion arsimor t'i jepet përparësi ngritjes dhe funksionimit, sipas legjislacionit në fuqi, të organizmave, si: bordi i institucionit arsimor; qeveria e nxënësve; këshilli i prindërve të institucionit arsimor; këshillat e prindërve të klasave; komisioni i disiplinës; komisioni i etikës dhe sjelljes; komisioni i shëndetit, sigurisë, mirëmbajtjes dhe mjedisit; komisioni i këshillimit të karrierës.

VIII. KONKURSET

1. Në zbatim të kreut XVIII të Dispozitave Normative 2013, të ndryshuara:

Çdo DAR/ZA të shpallë, brenda muajit shtator 2016, dy tema për konkurrim sipas përparësive vjetore.

Çdo kopsht/shkollë të shpallë konkursin vjetor për një ose dy tema të përzgjedhura nga këshilli i mësuesve.

2. Në përfundim të konkurseve kombëtare vjetore për të gjitha shkollat e vendit me temat:

a) Projektet kurrikulare;

b) Risi të shkollave në përkujdesjen ndaj nxënësve me vështirësi për të nxënë;

c) Risi të shkollave si qendra komunitare, një komision qendror i ngritur me urdhër të ministrit të Arsimit dhe Sportit të shpallë 10 shkollat/mësuesit fitues.

3. DAR/ZA-të të organizojnë ceremoni të posaçme për shpalljen e rezultateve të konkurseve në fund të vitit shkollor ose në fillim të vitit shkollor pasues.

KREU IV
POLITIKA DHE STRATEGJI

1. Shërbimi psikosocial

DAR/ZA të marrin masat për ngritjen dhe funksionimin e shërbimit psikosocial në zbatim të urdhrit nr. 344, datë 19.8.2016, "Për ngritjen e njësisë së shërbimit psikosocial" dhe të informojnë DAPU-në, brenda datës 30 shtator 2016.

2. Reduktimi i braktisjes shkollore

Për reduktimin e braktisjes shkollore, DAR/ZA-të dhe shkollat:

a) Të zbatojnë me përgjegjësi marrëveshjen e bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Ministrisë së Shëndetësisë (MSH), Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB) dhe Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, nr. 4024 prot., datë 2.8.2013, "Për identifikimin dhe regjistrimin në shkollë të të gjithë fëmijëve të moshës së detyrimit shkollor", si dhe urdhrin e përbashkët (MAS, MPB dhe MSH) nr. 2, datë 5.1.2015, "Për miratimin e Rregullores për zbatimin e marrëveshjes së bashkëpunimit, datë 2.8.2013, "Për identifikimin dhe regjistrimin në shkollë të të gjithë fëmijëve të moshës së detyrimit shkollor".

b) Të zbatojnë me përgjegjësi marrëveshjen e bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë nr. 4496, prot., datë 12.6.2015, "Për identifikimin dhe mbrojtjen e fëmijëve në situatë rruge".

c) Të koordinojnë bashkëpunimin ndërsektorial ndërmjet njësisë së mbrojtjes së fëmijëve dhe institucioneve të shoqërisë civile për zgjidhjen e problemeve të nxënësve braktisës.

d) Të dërgojnë në MAS të dhënat mbi lëvizjet e nxënësve të arsimit bazë, sipas afateve të përcaktuara në formularin operativ "Lëvizja dhe balancimi i kontingjenteve të nxënësve".

e) Të ndjekin me përparësi arsimimin e fëmijëve të ngujuar, funksionimin e klasave të shansit të dytë dhe zbatimin e procedurave të ndjekjes së arsimit bazë, sipas udhëzimit përkatës, për nxënësit që nuk kanë ndjekur të paktën dy klasa të arsimit bazë.

DAR/ZA-të të raportojnë në DAPU (MAS), dy herë në vit (në fund të muajit janar dhe në fund të vitit shkollor) punën e bërë për reduktimin e braktisjes shkollore.

3. Zbatimi i strategjive ndërsektoriale

a) Drejtoria e Arsimit Parauniversitar në MAS, DAR/ZA-të, IZHA-ja dhe Inspektorati Shtetëror i Arsimit (ISHA), në bazë të planit të veprimit për zbatimin e secilës strategji kombëtare ndër-ministrore, të caktojnë personat përgjegjës, të hartojnë plane pune vjetore me detyra konkrete dhe të monitorojnë përmbushjen e detyrimeve që lindin nga këto strategji.

b) DAR/ZA-të, IZHA-ja dhe ISHA-ja, të raportojnë në MAS, në fund të muajit janar dhe në fund të vitit shkollor, për problemet që lidhen me zbatimin e strategjive dhe planeve kombëtare të mëposhtme:

I. Plani Kombëtar i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve, 2016–2020, qëllimi strategjik i të cilit është ofrimi i arsimit cilësor dhe përfshirës për komunitetin rom dhe egjiptian dhe promovimi i dialogut ndërkulturor, përmes rritjes së mundësive të barabarta në të gjitha nivelet e sistemit arsimor. Me përparësi të ndiqen:

a) Ofrimi i arsimit cilësor dhe përfshirës për romët dhe egjiptianët dhe promovimi i dialogut ndërkulturor;

b) Rritja e numrit të romëve dhe egjiptianëve që përfundojnë të gjitha nivelet e arsimit;

c) Zhvillimi i një komuniteti shkollor që promovon dialogun ndërkulturor dhe mirëkuptimin e përbashkët;

d) Vlerësimi dhe promovimi i njohjes së identitetit rom dhe atij egjiptian si pjesë përbërëse e trashëgimisë kulturore të Shqipërisë.

II. Strategjia Kombëtare për Personat me Aftësi të Kufizuar. Për këtë, DAR/ZA-të dhe drejtoritë e institucioneve arsimore:

a) Të ndjekin me përparësi arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara (AK) dhe të krijojnë kushte për integrimin e tyre në kopshte e shkolla;

b) Të punojnë me përgjegjësi që nxënësit me AK të vlerësohen pranë DAR/ZA-së përkatëse nga komisionet multidisiplinare, e në zbatim të rekomandimit të dhënë nga Komisioni të trajtohen nga mësuesit, mësuesi ndihmës dhe psikologu i shkollës me plan edukativ individual.

III. Dokumenti Politik i Përfshirjes Sociale 2016–2020, miratuar me VKM-në nr. 87, datë 3.2.2016.

IV. Strategjia Kombëtare për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore. Për këtë:

DAR/ZA-të, drejtoritë dhe stafet e shkollave, si dhe njësitë e shërbimit psikosocial:

a) Të marrin masa për edukimin kundër trafikimit të fëmijëve, përmes trajtimit të moduleve të veçanta në kurrikulën me zgjedhje të lirë dhe aktiviteteve të ndryshme.

b) Të zbatojnë procedurat standarde të veprimit (PSV-të) për identifikimin dhe referimin e viktimave të mundshme të trafikut, si dhe të arsimojnë me përparësi, sipas akteve ligjore në fuqi, viktimat e trafikut, të identifikuara dhe të trajtuara në qendrat rezidenciale.

c) Të marrin masa për të zhvilluar aktivitete dhe fushata edukative e sensibilizuese në nivel shkolle dhe DAR-i, përgjatë muajit tetor 2016, si muaji i antitrafikut të qenieve njerëzore.

V. Strategjia Kombëtare kundër Drogës

DAR/ZA-të dhe drejtoritë e institucioneve arsimore të realizojnë trajnime dhe tema me mësues, nxënës dhe me komunitetin e prindërve për ndërgjegjësimin lidhur me rrezikun dhe luftën për parandalimin e përdorimit të drogës në shkollë dhe në komunitet.

VI. Strategjia Kombëtare e Barazisë Gjinore, Reduktimit të Dhunës me Bazë Gjinore dhe Dhunës në Familje. Për këtë:

a) DAR/ZA-të dhe drejtoritë e institucioneve arsimore të programojnë dhe të realizojnë trajnime me mësues dhe me komunitetin e prindërve për stereotipat gjinore në arsim dhe të caktojnë një mësues përgjegjës në çdo kopsht/shkollë që të mbulojë dhe të koordinojë aktivitetet për barazinë gjinore;

b) Në zhvillimin e edukimit për karrierën në arsimin bazë dhe në gjimnaz, institucionet arsimore të trajtojnë me përparësi mënjanimin e stereotipave gjinorë në përzgjedhjen e degëve dhe drejtimeve të studimit të mëtejshëm.

VII. Plani i Veprimit të Programit Kombëtar për Edukimin Mjedisor në shkollat e arsimit nëntëvjeçar në Shqipëri. Për këtë, DAR/ZA-të:

a) Të hartojnë planin e veprimtarive në zbatim të tij dhe ta dërgojnë atë në MAS brenda muajit tetor 2016;

b) Të përcaktojnë një koordinator për ndjekjen dhe zbatimin e këtij plani.

VIII. Plani i veprimit për Sigurinë e Fëmijëve në internet në shkollat e arsimit parauniversitar. Për këtë DAR/ZA-të;

c) Të koordinojnë veprimet për realizimin e fushatave ndërgjegjësuese dhe përdorimin e mjeteve për informimin e fëmijëve mbi abuzimin *online*, mbrojtjen dhe raportimin e krimeve;

d) Të koordinojnë veprimet për trajnimin e mësuesve për çështjet e informimit dhe edukimit.

IX. Plani i ri kombëtar për ushqimin dhe ushqyerjen. Për këtë:

a) DAR/ZA-të të planifikojnë veprimtari gjithëvjetore në zbatim të programit, "Për një ushqyerje të shëndetshme".

b) Për zbatimin e planit të përdoret paketa didaktike e përgatitur nga IZHA-ja dhe Instituti i Shëndetit Publik.

1. Marrëveshja e bashkëpunimit nr. 3019 prot., datë 16 prill 2015, midis Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Shoqatës Kombëtare Shqiptare të Njerëzve që nuk Dëgjojnë. Për këtë:

Çdo DAR/ZA të fillojë identifikimin e fëmijëve me probleme të të dëgjuarit, të cilët nuk frekuentojnë, duke mos realizuar detyrimin shkollor, si dhe të marrë masa për përfshirjen e tyre në arsimin bazë, të zakonshëm apo special, në varësi të nivelit të paaftësisë.

2. Marrëveshja e bashkëpunimit midis Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Federatës Evropiane të Shahut dhe Federatës Shqiptare të Shahut nr. 4661/1 prot., datë 18.6.2015, "Për implementimin e projektit "Mësime të shahut në shkollë".

KREU V
VEPRIMTARI SHKOLLORE DHE JASHTËSHKOLLORE

Në zbatim të nenit 9 të kreut III të Dispozitave Normative, të ndryshuara, për veprimtaritë shkollore dhe jashtëshkollore, si dhe veprimtari të tjera plotësuese, pa cenuar orët mësimore të parashikuara në programet lëndore, për asnjë nxënës, të ndiqen me përparësi nga DAR/ZA-të dhe drejtoritë e institucioneve arsimore:

1. Konsolidimi i nismës "Shkollat si qendra komunitare (SHQK), një shkollë miqësore për të gjithë", në dy aspekte:

a) Të konsolidohet SHQK, duke rivlerësuar shkollat për përmbushjen e standardeve dhe kritereve të përcaktuara për SHQK-në. Pjesë e kësaj liste të jenë shkollat pjesë e programeve të bashkëpunimit me Save the Children, World Vision, UNICEF, JACA dhe shkollat që mbulohen nga Kabineti i Ministrave. Të reflektohen në listë dhe të njoftohet DAPU-ja nëse deri tani këto shkolla nuk kanë qenë pjesë e kësaj liste.

b) Të fuqizohen koordinatorët e SHQK-së, në nivel shkolle dhe DAR/ZA-je, si më poshtë:

- Koordinatori shkollor të jetë në rolin përgjegjës për hartimin e planit vjetor në zbatim të standardeve të SHQK-së, udhëzuesve përkatës dhe materialeve ndihmëse të ofruara nga MAS-i dhe IZHA-ja, në bashkëpunim me partnerët.

- Koordinatori i DAR/ZA-së të përmbledhë dhe dërgojë në DAPU në MAS planin vjetor të SHQK-së për qarkun, brenda datës 15 tetor 2016.

- Koordinatorët shkollore të sigurojnë që qeveritë e nxënësve, bordi i shkollës dhe përfaqësuesit e komunitetit, pushtetit vendor, organizatave, bizneseve në zonë etj., të angazhohen në hartimin e planit vjetor të shkollës qendër komunitare dhe të kontribuojnë në zbatimin e tij.

- Koordinatori për DAR/ZA-në të planifikojë veprimtari trajnuese me stafin pedagogjik, dhe anëtarët e organizmave të shkollës, për shkollat pjesë e nismës SHQK, për njohjen dhe zbatimin e dokumenteve të nismës, duke shfrytëzuar mundësitë e bashkëpunimit me partnerët që zotërojnë ekspertizë në këtë fushë.

- Dokumentet e hartuara nga partneret tanë në këtë proces, UNICEF-i, Save the Children, World Vision etj., pasi janë njohur nga MAS-i (IZHA), të shërbejnë si dokumente mbështetëse në trajnimet e koordinatorëve të përbashkëta me partnerët, si dhe në hartimin e planeve zhvillimore të shkollës.

- Këto dokumente gjenden të publikuara në faqen e internetit të IZHA-së, www.izha.edu.al dhe në portalin shqk.edu.al.

- Koordinatori shkollor i SHQK-së lehtëson analizën përmes përdorimit të portalit *online* për SHQK-në. Informacioni dhe të dhënat të merret në faqen e internetit shqk.edu.al.

- Çdo shkollë qendër komunitare disponon adresën e përdoruesit dhe fjalëkalimin përkatës. Çdo koordinator i SHQK-së lehtëson analizën e treguesve me çdo grup interesi, si: anëtarë të qeverisë së nxënësve dhe përfaqësues të nxënësve të shkollës; anëtarë të bordit të shkollës dhe prindër nga këshillat e prindërve, si dhe anëtarë të komunitetit e mësues të shkollës.

- Pasi pikëzimi dhe analiza është kryer fillimisht me çdo grup në shkollë, koordinatori i SHQK-së ngarkohet me lehtësimin e një seminari ku diskutohet pikëzimi për çdo tregues të portalit me përfaqësues nga të tri grupimet dhe vendosen pikë që automatikisht gjenerojnë fushën e SHQK-së, e cila përditësohet nga vetë shkolla gjatë vitit.

c) Koordinatorët e SHQK-së në DAR/ZA të planifikojnë veprimtari promovuese për SHQK-në dhe të pasqyrojnë të gjitha veprimtaritë e SHQK-ve përmes faqeve të internetit dhe mediave lokale; të nxisin stafet dhe organizmat e shkollave për shkëmbimin e përvojave dhe praktikave më të mira në qark; të shikojnë mundësitë për realizimin e

bashkëpunimeve me partnerët e huaj dhe vendas në funksion të pasurimit të veprimtarive të SHQK-ve.

d) Ngarkohen DAR-ZA-të me monitorimin e procesit të vetëvlerësimit të shkollave SHQK, që do të bëhet në muajin nëntor 2016, për të siguruar që shkollat të hartojnë planet e SHQK-së.

2. Karta e Performancës së vitit 2015–2016 dhe 2016–2017

a) Në kartën e vitit shkollor 2015–2016, shkollat do të llogarisin edhe ndryshimet në vlerë për treguesit e pasqyruar një vit më parë.

b) Në dërgimin e të dhënave që burojnë nga shkolla të sqarohet edhe proceduara e përpunimit të të dhënave siç është përcaktuar në udhëzues.

c) Për vitin shkollor 2015–2016, shkollat të renditen në nivel rajonal edhe për rezultatet e arritura në vlerësimin e kryer në klasat e pesta.

d) DAR/ZA-të mund të vendosin të ketë tregues rajonalë ose jo (p.sh., të dhëna për lëndët me zgjedhje).

e) DAR/ZA-të të verifikojnë të dhënat e dërguara nga shkollat deri më 3.9.2016, duke u mbështetur në procedurën e përcaktuar në "Udhëzuesi për Kartën e Performancës së Shkollës" dhe të qarkullojnë letër informuese, nëse ka pasaktësi dhe të ndërmarrin veprimet përkatëse.

f) Çdo shkollë në arsimin parauniversitar, deri më 3.9.2016, të hartojë Kartën e Performancës së Shkollës për vitin shkollor 2015–2016, mbështetur në "Udhëzuesi për Kartën e Performancës së Shkollës,, dhe ta bëjë atë publike për prindërit dhe komunitetin.

g) Në fund të muajit shtator 2016, DAR/ZA-të të shpallin shkollat e suksesshme në zbatimin të nenit 126/4 të Dispozitave Normative, 2013, të ndryshuara.

h) Në vijim, çdo shkollë e arsimit para-universitar të hartojë Kartën e Performancës së Shkollës (Karta), me treguesit e përzgjedhur për vitin shkollor 2016–2017, bazuar në "Udhëzuesi për Kartën e Performancës së Shkollës".

i) Në kartën e vitit shkollor 2016–2017, shkollat të llogarisin edhe ndryshimin në vlerë për treguesit e pasqyruar në Kartën e Performancës së vitit paraardhës.

3. Zbatimi i Portofolit Evropian të Gjuhëve (PEGJ)

a) Në kuadrin e orientimit të nxënësve në arsimin parauniversitar për njohjen e kompetencave gjuhësore sipas Kuadrit të Përbashkët Evropian të Referencës për Gjuhët, mësimdhënia, nxënia, kurrikula e re, realizimi i provimeve kombëtare për arsimin bazë dhe arsimin e mesëm në lëndën "Gjuhë e huaj", si dhe vlerësimi sipas kurrikulës së re mbështetur mbi portofolin e nxënësit, të bazohen në zbatimin e Portofolit Evropian të Gjuhëve.

b) Portofoli Evropian i Gjuhëve të përdoret si material ekstrakurrikular në lëndën "Gjuhë e huaj". Portofoli është pronë e nxënësit dhe nuk fotokopjohet.

c) Nxënësi pajiset me Portofolin Evropian të Gjuhëve për gjuhën angleze dhe frënge në dy klasa gjatë gjithë shkollimit të tij, në klasën VI dhe klasën X.

d) Modelet shqiptare të akredituara nga Këshilli i Evropës janë nr. 96.2008, për arsimin e mesëm dhe nr. 106.2010, për arsimin bazë.

e) Në zbatim të marrëveshjes për programin "Iliria", të gjitha shkollat pjesë e këtij programi të pajisen me Portofolin Evropian të Gjuhëve për tri klasa bazë: klasat III, VI dhe X sipas modeleve të regjistruara dhe të shpërndara në seminarin kombëtar për programin "Iliria".

f) Kërkesat për këtë dokument do të dërgohen pranë Zyrës për Arsimin të Ambasadës Italiane dhe DAPU në MAS.

g) Brenda datës 30 shtator 2016, DAR/ZA-të të raportojnë në DAPU për nevojat për pajisje me këtë dokument dhe për trajnim, nëse ka.

4. Planifikimi, organizimi dhe realizimi i veprimtarive edukative, shkencore, artistike, kulturore e sportive gjithëvjetore në shkollë dhe ndërshkollore jashtë procesit mësimor, me përfshirjen e nxënësve në:

a) Kampionatin Kombëtar të Shahut për arsimin 9-vjeçar, në bashkëpunimin me Federatën Shqiptare të Shahut. Faza e parë në bazë shkolle të zhvillohet në muajin dhjetor, faza e dytë në bazë qarku në muajin shkurt dhe finalja në mars-prill.

b) Veprimtaritë në kuadër të 6 Prillit - Ditës Ndërkombëtare kushtuar Sportit për Zhvillim e Paqe.

c) Javën Olimpike (prill–maj).

d) Olimpiadat kombëtare që zhvillohen në datat e përcaktuara në kalendarin e miratuar nga MAS-i.

e) Festivalin Kombëtar të Këngës për Fëmijë: faza e parë në shkolla në janar–shkurt; faza e dytë

në bazë qarku organizuar nga qendrat kulturore të fëmijëve (QKF) në mars dhe finalja në Shkodër në qershor, nga QKF-ja Shkodër.

f) Festivalin mbarëkombëtar të instrumentistëve të vegjël popullorë, organizuar nga QKF Fushë-Arrëz, javën e tretë të muajit maj.

g) Konkursin artistik "Piktori i vogël". Faza e parë në bazë shkolle javën e dytë të dhjetorit; faza e dytë në bazë qarku javën e parë të shkurtit dhe finalja në Tiranë, në javën e fundit të shkurtit.

h) Ditën Evropiane të Gjuhëve, 26 Shtator 2016.

i) Ditën Botërore të Gjuhës Amtare, 21 Shkurt 2016.

j) Ditën Ndërkombëtare *eTwinning*, 7 Maj 2016.

k) Përkujtimin e Holokaustit dhe krimeve kundër njerëzimit, më 27 Janar 2017.

l) Veprimtaritë për 8 Prillin – Ditës Ndërkombëtare të Romëve.

m) Veprimtaritë për 23 Gushtin - Ditën Evropiane të Kujtesës për të Gjitha Viktimat e Regjimeve Totalitare.

n) Veprimtaritë për 12 Qershorin - Ditën kundër Shfrytëzimit të Punës së Fëmijëve.

o) Veprimtaritë sipas Kalendarit të ditëve të Evropës dhe veprimtaritë gjithëvjetore për njohjen e institucioneve të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës.

p) Konkurset në nivel DAR/ZA-je, me tematikë "Të njohim Evropën".

q) Javën Evropiane të Lëvizjes "*Now we move*".

KREU VI
INSPEKTIMI

Inspektorati Shtetëror i Arsimit të ketë përparësi:

a) Vlerësimin e cilësisë së shërbimit që ofrojnë njësitë arsimore vendore (NJAV) dhe institucionet arsimore, mbështetur në manualet përkatëse të ISHA-së dhe bazën ligjore të përditësuar.

b) Inspektimin e zbatimit të kritereve ligjore në funksionimin e institucioneve arsimore publike dhe private.

c) Rekomandimet për ndryshime në bazën ligjore, për organizimin dhe funksionimin e institucioneve arsimore publike dhe private.

d) Inspektimin e dokumentacionit të NJAV-ve dhe shkollave për përpunimin e të dhënave të Kartës së Performancës në përputhje me Udhëzuesin e Kartës së Performancës dhe Dispozitat Normative 2013, të ndryshuara.

e) Pilotimin e instrumenteve dhe treguesve të draftmanualit për vlerësimin e kurrikulës.

f) Vlerësimin e procesit të hartimit dhe realizimit të vetëvlerësimit, planeve afatmesme dhe vjetore në institucionet arsimore parauniversitare (nenet 66, 67, 68 DN).

g) Monitorimin e procesit të përzgjedhjes dhe të shpërndarjes së librit shkollor.

h) Monitorimin e procesit të zhvillimit të praktikave profesionale të kandidatëve për mësues.

i) Monitorimin e procesit të zhvillimit të kualifikimit të mësuesve.

j)Monitorimin e Maturës Shtetërore; provimeve të lirimit; olimpiadave; provimeve të vlerësimit të arritjeve për klasat e pesta etj.

k) Monitorimin e korrigjimit të testeve në qendrat e korrigjimit të provimeve.

l) Shërbimin psikosocial në sistemin arsimor parauniversitar, në funksion të edukimit kundër dhunës dhe sjelljeve të rrezikshme.

m) Zbatimin e legjislacionit për procedurat e emërimit dhe shkarkimit të drejtuesve dhe mësuesve, mësuesve ndihmës, në institucionet arsimore publike të sistemit parauniversitar.

n) Procesin e hartimit dhe zbatimit të projekteve lëndore dhe ndërlëndore.

o) Vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies në lëndët e edukimit artistik dhe sportiv në shkolla.

p) Funksionimin e gjimnazeve publike me kohë të pjesshme.

q) Organizimin dhe funksionimin e qendrave kulturore të fëmijëve.

KREU VII
DISPOZITA TË FUNDIT

1. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen: MAS-i, IZHA-ja, ISHA-ja, AKP-ja, DAR/ZA-të dhe institucionet arsimore të sistemit parauniversitar.

2. DAR/ZA-të të marrim masat e duhura që ky udhëzim të shpërndahet në çdo shkollë dhe me përmbajtjen e tij të njihet çdo punonjës i arsimit.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I MIRËQENIES SOCIALE
DHE RINISË
Blendi Klosi

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT
Lindita Nikolla

UDHËZIM
Nr. 17, datë 3.8.2016

PËR PROCEDURAT DHE KRITERET PËR NJOHJEN DHE NJËSIMIN NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË, TË DIPLOMAVE, CERTIFIKATAVE, GRADAVE SHKENCORE DHE TITUJVE AKADEMIKË, TË LËSHUARA NGA INSTITUCIONET E HUAJA TË ARSIMIT TË LARTË DHE INSTITUCIONE TË TJERA TË AUTORIZUARA, JASHTË VENDIT

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 92, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë",

UDHËZOJ:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Të drejtën për njohjen dhe njësimin e certifikatave, diplomave, gradave shkencore dhe titujve akademikë, të fituara jashtë vendit, e ka Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS).

Njohja dhe njësimi ka për qëllim njohjen e së drejtës për të vazhduar arsimimin, punësimin ose karrierën akademike në Republikën e Shqipërisë.

Veprimtaria e njohjes dhe njësimit të diplomave dhe certifikatave, nënkupton administrimin dhe kryerjen e procedurave për të gjitha aplikimet për njohjen dhe njësimin e kualifikimeve që u përkasin niveleve nga 5 deri në 8 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, si dhe të titujve akademikë, të lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë apo nga institucione të tjera të autorizuara nga kuadri ligjor i vendit përkatës për lëshimin e tyre.

1. Termat e mëposhtëm, të përdorur në këtë udhëzim, kanë kuptimin:

a) "Kualifikim" është një program studimi në përfundim të të cilit është lëshuar një certifikatë apo diplomë e vlefshme zyrtarisht në vendin e origjinës që vërteton përfundimin e tij;

b) "Korniza Shqiptare e Kualifikimeve", në vijim (KSHK), sipas përcaktimeve të ligjit nr. 10247, datë 4.3.2010, "Për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve" është një sistem kombëtar për klasifikimin e kualifikimeve, sipas një tërësie kriteresh, për nivele specifike të të nxënit të përftuar, që ka për qëllim integrimin dhe koordinimin e nënsistemeve kombëtare të kualifikimeve dhe përmirësimin e transparencës, aksesit, përparimit dhe cilësisë së kualifikimeve që lidhen me tregun e punës dhe shoqërinë civile.

c) "Korniza Evropiane e Kualifikimeve", në vijim (KEK), sipas ligjit nr. 10247, datë 4.3.2010, është një kornizë, që përmban 8 nivele, të miratuara nga Parlamenti Evropian, për të ndihmuar vendet dhe sektorët të krahasojnë kualifikimet, të përmirësojnë njohjen e ndërsjellë dhe të nxisin lëvizjen gjeografike, si dhe të nxënit gjatë të gjithë jetës.

d) "Institucione të autorizuara" janë institucione kompetente, të cilat nuk janë institucione të arsimit të lartë, por lëshojnë diploma dhe certifikata të arsimit të lartë të vlefshme në vendin e origjinës, që vërtetojnë përfundimin e studimeve, konform kuadrit ligjor në fuqi të vendit përkatës.

2. Ministria e Arsimit dhe Sportit nuk shqyrton aplikimet për rastet si më poshtë:

i) certifikata, diploma universitare dhe grada shkencore për programe studimi të ndjekura në Republikën e Shqipërisë;

ii) certifikata, diploma universitare dhe grada shkencore të fituara nga ndjekja e programeve të studimit *online* apo në distancë;

iii) dokumente për programe studimi të papërfunduara. Këto dokumente shqyrtohen nga institucioni i arsimit të lartë pranë të cilit aplikohet për transferim studimesh;

iv) certifikata/dëshmi për kurse kualifikimi ose plotësuese, si gjuhë e huaj, kompjuter etj.;

v) diploma ose certifikata të fituara në institucione ushtarake të arsimit të lartë, përjashtuar diplomat për drejtime civile të studimeve;

vi) certifikata, diploma universitare dhe grada shkencore të fituara në institucione fetare të arsimit të lartë, përjashtuar diplomat me drejtim civil studimi.

3. Kriteret që duhet të përmbushë certifikata dhe/ose diploma për t'u njohur dhe njësuar, janë:

1) Të jetë lëshuar nga institucione të licencuara, të njohura/akredituara të arsimit të lartë apo institucione të autorizuara në vendin e origjinës;

2) Programi i studimit në përfundim të të cilit lëshohet certifikata apo diploma të jetë i njohur/ akredituar në kohën e ndjekjes së studimeve dhe momentin e lëshimit të dokumentit në fjalë;

3) Certifikata apo diploma të jetë e vlefshme në vendin e origjinës;

4) Certifikata apo diploma të jetë autentike.

KREU II
MËNYRA E APLIKIMIT

1. Mënyrat e aplikimit për njohjen dhe njësimin e kualifikimeve që i përkasin nivelit nga 5 deri në 8 të Kornizës Shqiptare apo Evropiane të Kualifikimeve, janë:

a) Aplikim shkresor (*hard-copy*), në rrugë postare;

b) Aplikim *online*, në faqen zyrtare të MAS-it, në rubrikën e rezervuar të njësimit të diplomave të huaja sipas manualit të përdoruesit, publikuar në faqen zyrtare të MAS-it.

Në rastet e aplikimit *online*, ai duhet të shoqërohet me dërgimin në rrugë postare të dokumentacionit përkatës (*hard-copy*) në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit.

Aplikimi për njohjen e titujve akademikë mund të bëhet vetëm përmes aplikimit shkresor (*hard-copy*).

Aplikimi shkresor dërgohet nga aplikanti në rrugë postare në MAS dhe më pas depozitohet në Sektorin e Protokollit në MAS, ku merr dhe numrin e regjistrit përkatës.

Në rastet kur aplikimi kryhet vetëm *hard-copy*, sektori i protokollit regjistron dhe hedh të dhënat në sistemin *online*. Në përfundim të procedurës, sektori i protokollit i dërgon me *email* aplikantit *username* dhe *password*-in e tij, të krijuar gjatë procesit të hedhjes së të dhënave. Aplikanti bën ndryshimin e *password*-it *online*.

Në rastin e aplikimit *online* dokumentacioni përcillet dhe në format *hard-copy* në rrugë postare në MAS dhe i përcillet më pas sektorit të njohjes së diplomave.

KREU III
DOKUMENTACIONI QË DUHET TË PËRMBAJË APLIKIMI

1. Dokumentacioni i dërguar në rrugë postare në MAS për të dyja format e aplikimit të parashikuara në pikën 1 të kreut II të këtij udhëzimi, për njësimin e certifikatave dhe diplomave universitare të nivelit 5 deri në nivelin 8 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK) dhe Kornizës Evropiane të Kualifikimeve (KEK) (me përjashtim të diplomave të doktoratës), duhet të përmbajë:

a) formularin e aplikimit të plotësuar individualisht, i cili shkarkohet nga faqja zyrtare e MAS-it (në rast se aplikohet vetëm në formë shkresore) ose atë të printuar pas aplikimit *online* (në rast se aplikohet *online*);

b) diplomën[1] ose certifikatën që vërteton përfundimin e studimeve (në rastet kur ky përbën dokumentin zyrtar përkatës në vendin e origjinës ekuivalent me diplomën);

c) listën e notave dhe/ose suplementin e diplomës;

d) fotokopje e kartës së identitetit ose të pasaportës;

e) mandat pagesën *hard-copy* (në rastet kur aplikimi kryhet vetëm në rrugë shkresore).

1.2 Dokumentet e përcaktuara në këtë pikë të udhëzimit duhet të jenë dokumente origjinale (me përjashtim të diplomës) ose fotokopje të njësuara me origjinalin. Dokumenti i shkronjës "b" dhe/ose "c", duhet të jetë i pajisur me vulën apostille/ legalizimin[2]. Në rastet kur kjo vulë/vërtetim, për sa më sipër, mungon, ndiqet procedura e përcaktuar në pikën 2.1 të kreut IV të këtij udhëzimi.

Dokumentet e dorëzuara për njohje nuk i kthehen më aplikantit.

Dokumentet e përcaktuara në germat "b" dhe "c" duhet të jenë të përkthyera në gjuhën shqipe

[1] Diplomat e lëshuara në Republikën e Kosovës duhet të pajisen me vulën përkatëse nga MASHT-i dhe Agjencia e Akreditimit e Kosovës.

[2] Të gjitha dokumentet shkollore, që lëshohen nga institucionet arsimore të shteteve që janë palë e Konventës së Hagës, duhet të pajisen me vulën apostile. Bëjnë përjashtim dokumentet arsimore të lëshuara nga shtetet: Greqi, Gjermani, Spanjë, të cilat duhen të legalizohen nga përfaqësitë diplomatike shqiptare në këto shtete. E njëjta procedurë legalizimi vlen edhe për ato shtete të cilat nuk janë pjesë (palë) e Konventës së Hagës.

nga përkthyes të licencuar në Republikën e Shqipërisë, me përjashtim të dokumentacionit në gjuhën angleze, italiane dhe frënge për të cilat nuk është i domosdoshëm përkthimi në gjuhën shqipe. Në rastet e pamundësisë së kryerjes së procedurave të përkthimit në gjuhën shqipe, aplikanti mund të përkthejë dokumentin në vendin e origjinës në gjuhën angleze nga një përkthyes i autorizuar /licencuar për këtë qëllim, në vendin përkatës. Në këto raste dokumenti duhet të mbajë domosdoshmërish vulën apostile/legalizimin lidhur me përkthimin.

2. Aplikimi për njohjen dhe njësimin e gradës shkencore "doktor", duhet të përmbajë dokumentacionin si më poshtë:

a) formularin e aplikimit të plotësuar individualisht, i cili shkarkohet nga faqja zyrtare e MAS-it (në rast se aplikohet vetëm në formë shkresore) ose i printuar pas aplikimit *online* (në rast se aplikohet *online*);

b) kopje të diplomës dhe suplementit të saj (nëse ka të tillë) të lëshuar nga institucioni përkatës i arsimit të lartë, që dëshmon fitimin e gradës shkencore "doktor", si dhe kopje të noterizuara të studimeve pararendëse universitare;

c) disertacionin e doktoratës, në format *hard-copy* (*të lidhur dhe firmosur nga aplikanti dhe udhëheqësi shkencor. Në mungesë të firmosjes nga udhëheqësi, të siglohet nga sekretaria mësimore e institucionit të arsimit të lartë dhe të vuloset*) dhe elektronik (në CD në format Word);

d) përmbledhje në gjuhën shqipe të disertacionit në format *hard-copy* (të firmosur nga aplikanti) dhe elektronik (në CD në format Word), 5–10 faqe;

e) vërtetimin e lëshuar nga Biblioteka Kombëtare në Tiranë, të depozitimit të kopjes së disertacionit;

f) *Curriculum Vitae* të firmosur nga aplikanti;

g) fotokopje të kartës së identitetit ose të pasaportës;

h) mandat pagesën *hard-copy* (në rastet kur aplikimi kryhet vetëm në rrugë shkresore).

2.1 Dokumentet e përcaktuara në pikën 2 të këtij kreu të udhëzimit duhet të plotësojnë kërkesat e parashikuara në pikën 1.2 të këtij kreu.

3. Aplikimi për njohjen e titujve akademikë "profesor" dhe "profesor i asociuar", duhet të përmbajë dokumentacionin si më poshtë:

a) kërkesë me shkrim për njohjen e titullit akademik;

b) dokumenti i fitimit të titullit akademik, fotokopje e njësuar me origjinalin;

c) diplomën e fitimit të gradës shkencore "doktor", fotokopje e njësuar me origjinalin;

d) dokumente që certifikojnë fitimin e titujve të tjerë akademikë;

e) vërtetimin e regjistrimit të titullit akademik në *database*-n në zbatim të kuadrit ligjor të vendit përkatës;

f) *Curriculum Vitae*;

g) fotokopje e kartës së identitetit apo pasaportës;

h) aplikimi të shoqërohet me një skedë që duhet të plotësohet prej kërkuesit në të cilin të jepet informacion, për:

i) eksperiencën akademike mësimdhënie;

ii) aktivitetin shkencor – pjesëmarrje në simpoziume, konferenca, kongrese shkencore, të shoqëruara me titujt e materialeve të paraqitura;

iii) botime të punimeve shkencore në organe shkencore ndërkombëtare.

Informacioni i parashikuar në këtë skedë duhet të shoqërohet me dokumentacion provues përkatës;

i) informacion mbi bazën ligjore për përfitimin dhe mbajtjen e titullit në vendin e origjinës.

Dokumentet e përcaktuara në germat "b", "c", "d" dhe "e" duhet të jenë të përkthyera në gjuhën shqipe nga një përkthyes i licencuar në Republikën e Shqipërisë, përveç dokumenteve në gjuhën angleze, frënge dhe italiane;

KREU IV
PROCEDURAT E NJOHJES

1. Procedura e njohjes dhe e njësimit, pas aplikimit *online* ose pas hedhjes së të dhënave, vijon me shqyrtimin dhe verifikimin e dokumentacionit nga ana e Sektorit të Njohjes së Diplomave (SENJOD). Aplikimi nuk quhet i plotë, nëse mungon një nga dokumentet e cituara në këtë udhëzim. Informimi për plotësim dokumentacioni bëhet me *email* ose postë të zakonshme. Procedura e njohjes dhe njësimit vijon vetëm në rastet kur dokumentacioni i përcaktuar si i detyrueshëm në formularin e aplikimit është i plotë. Aplikimi nuk konsiderohet i plotë nëse formulari i aplikimit nuk përmban të gjitha të dhënat e kërkuara me detyrim aty. Në këto raste dosja arkivohet dhe aplikanti njoftohet me *email*.

2. Afatet e përcaktuara në këtë udhëzim për njësimin e kualifikimeve, gradave apo titujve i referohen datës së plotësimit të praktikës me të gjithë dokumentacionin e plotë.

3. Në rastet e aplikimit *online,* kandidati njoftohet automatikisht me *email* për plotësimin e aplikimit, si dhe për komunikimet me institucionet e huaja lidhur me praktiken e depozituar.

4. Verifikimi i dokumenteve:

4.1 SENJOD-i, në cilësinë e sekretariatit teknik, kryen verifikimin e autenticitetit të diplomës apo certifikatës, në rastet kur këto dokumente nuk janë të pajisur me vulë apostille/legalizim apo nuk janë të legalizuara në vendin e origjinës sipas përcaktimeve në këtë udhëzim, si dhe në rastet e dokumentacionit të lëshuar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Në këtë rast, SENJOD-i kontakton me *email* ose në rrugë postare me institucionin që ka lëshuar diplomën apo certifikatën përkatëse. SENJOD-i mund të kërkojë dhe informacion të mëtejshëm që e konsideron të nevojshëm për vlerësimin objektiv për njohjen dhe njësimin e diplomës apo certifikatës.

4.2 SENJOD-i kërkon informacion pranë qendrave të rrjetit evropian të informimit dhe njohjes së diplomave (ENIC–NARIC), mbi statusin e institucioneve të arsimit të lartë, vlefshmërinë e diplomave apo certifikatave, nivelin e tyre sipas kornizës kombëtare apo evropiane të kualifikimeve, si dhe informacion tjetër shtesë në funksion të njësimit të diplomës. SENJOD-i shërben dhe si qendra kombëtare e rrjetit ENIC/NARIC për informimin dhe njohjen e diplomave për Shqipërinë.

4.3 Materialet shkresore ose të printuara për të gjitha verifikimet e kryera, depozitohen në dosjen e aplikantit. Për verifikimet e kryera *online* ose me *pin code* të aplikantit, dokumentacioni i printuar firmoset nga nëpunësi që kryen verifikimet dhe depozitohet në dosjen e aplikantit.

5. Procedurat për marrjen e vendimit të njohjes dhe të njësimit:

5.1 Për njohjen dhe njësimin e certifikatave dhe diplomave të lëshuara në përfundim të programeve të studimit, që i përkasin nivelit 5 deri në 8 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve dhe Kornizës Evropiane të Kualifikimeve, përveç gradave shkencore "doktor", ngrihet Komisioni i Njohjes së Diplomave, në përbërje të të cilit janë nëpunës të Drejtorisë së Arsimit të Lartë dhe Shkencës në MAS dhe drejtohet nga drejtori i kësaj drejtorie.

5.2 Komisioni i Njohjes së Diplomave vlerëson, njeh dhe njëson, në bazë të Kornizës Evropiane të Kualifikimeve, të Kornizës së Kualifikimeve të vendit të origjinës dhe të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, sipas parimeve dhe standardeve ndërkombëtare të njohjes së kualifikimeve, përcaktuar në dokumentet, marrëveshjet dhe konventat ndërkombëtare, në të cilat përfshihet vendi ynë duke respektuar dhe parashikimet e kuadrit ligjor shqiptar në fuqi.

5.3 Komisioni i Njohjes së Diplomave merr vendimin për njohje dhe njësim ose mund të vendosë t'ia kthejë dosjen SENJOD-it, për plotësime të nevojshme në dokumentacion, sipas këtij udhëzimi. SENJOD-i, në bazë të vendimit të Komisionit, përgatit vërtetimin e njohjes dhe njësimit, për çdo aplikant. Në rastet e mosnjohjes së diplomës apo certifikatës, SENJOD-i përgatit përgjigjen përkatëse për aplikantin.

5.4 Për njohjen e gradave shkencore dhe titujve akademikë ngrihen me urdhër të ministrit përgjegjës për arsim, komisione *ad hoc* sipas fushave përkatëse me pedagogë ekspertë të fushës të kategorisë "profesor", i cili mblidhet në varësi të numrit të aplikimeve dhe shqyrton dosjet përkatëse. Kryetar i komisionit është ministri i Arsimit dhe Sportit. Komisioni përkatës nuk mund të mblidhet më vonë se 15 ditë kalendarike pas njoftimit për shqyrtimin e një aplikimi. Në përfundim të procedurave të shqyrtimit komisioni firmos procesverbalin dhe ministri i Arsimit dhe Sportit lëshon vërtetimin për njohjen e gradës shkencore apo titullit akademik.

6. Vërtetimi i njohjes dhe i njësimit (me përjashtim të gradave shkencore dhe titujve akademikë) lëshohet nga Ministria e Arsimit dhe Sportit në përfundim të procedurës së njohjes, pas depozitimit të aplikimit në formë shkresore, jo më vonë se një javë nga përfundimi i procedurës së njohjes. Vërtetimi nënshkruhet nga kryetari i Komisionit dhe kundërfirmoset nga Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit (ose një person i autorizuar prej tij). Formati i vërtetimit të njohjes dhe njësimit, bashkëlidhur shtojca 1, përmban këto elemente:

a) emrin dhe mbiemrin e kandidatit;

b) institucionin e arsimit të lartë që ka lëshuar diplomën/certifikatën;

c) shtetin përkatës;

d) kohëzgjatjen zyrtare të programit të studimit;

e) numrin e krediteve të përfituara sipas sistemit ECTS (*European Credit Transfer System* – Sistemi Evropian i Transferimit të Krediteve), në ato raste kur është e mundur të përcaktohet në bazë të të dhënave të suplementit të diplomës ose listës së notave, si numër total kreditesh të përfituara;

f) emërtimin e programit të studimit;

g) njësimin e certifikatës/diplomës në Republikën e Shqipërisë.

Vërtetimi i njohjes dhe njësimit është i aksesueshëm *online* në çdo kohë nga aplikanti, kundrejt *username*-it dhe *password*-it të tij për aplikantët që kanë ndjekur procedurën e aplikimit *online*.

KREU V
AFATET

Procedurat për njohjen dhe njësimin e diplomave, certifikatave dhe gradave shkencore të fituara në përfundim të studimeve të kryera jashtë vendit, si dhe njohjen e titujve akademikë të lëshuar nga institucione të huaja të arsimit të lartë, kur dosja e aplikimit është e plotësuar me të gjithë dokumentacionin e kërkuar në këtë udhëzim, përfundojnë brenda 45 ditëve në rastet e aplikimit *online*, dhe brenda 3 muajve në rastet e aplikimit në formë shkresore.

Ministria e Arsimit dhe Sportit nuk mban përgjegjësi për vonesa që vijnë për shkak të mungesës së përgjigjes, ose të përgjigjes së vonuar nga ana e aplikantit për dorëzimin e dokumenteve plotësuese apo për mungesën e përgjigjes /përgjigjes së vonuar të institucionit të arsimit të lartë që ka lëshuar diplomën, apo qendrës kombëtare përkatëse të rrjetit ENIC-NARIC.

KREU VI
TARIFAT

Tarifa për njohjen dhe njësimin e certifikatave dhe diplomave që i përkasin nivelit 5 deri në 8 të kornizës shqiptare të kualifikimeve dhe kornizës evropiane të kualifikimeve (me përjashtim të njësimit të gradave shkencore), për çdo diplomë që kërkohet të njësohet, është 2,000 (dy mijë) lekë për aplikimet e kryera *online* dhe 4,000 (katër mijë) lekë për aplikimet e kryera vetëm në formë shkresore. Për gradat shkencore tarifa për çdo diplomë që kërkohet të njësohet, është 3,500 (tre mijë e pesëqind) lekë për aplikimet e kryera *online* dhe 5,000 (pesë mijë) lekë për aplikimet e kryera vetëm në formë shkresore.

Tarifa për njohjen e titujve akademikë është 5,000 (pesë mijë) lekë.

Pagesa kryhet në llogarinë bankare të MAS të përcaktuar në faqen *web* të MAS-it në seksionin përkatës të njohjes së diplomave. Mandatpagesa dorëzohet me dosjen e aplikimit për aplikimin shkresor. Për aplikimin *online* ndiqen procedurat e parashikuara në manualin përkatës të publikuar në faqen zyrtare të MAS-it.

KREU VII
ANKIMIMI

Aplikanti ka të drejtë të bëjë ankimim me shkrim drejtuar Komisionit të Njohjes së Diplomave, brenda 30 ditëve nga tërheqja e vërtetimit të njohjes dhe njësimit, për njohjen e diplomave të niveleve 5 deri 8 të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve, me përjashtim të njohjes së gradës shkencore "doktor" dhe titujve akademikë për të cilin i drejtohet Komisionit *ad hoc* përkatës. Ankesa duhet të shoqërohet me dokumentacionin mbi të cilët mbështeten pretendimet e ankuesit. Afati i ankimimit dhe kthimit të përgjigjes për ankesën i referohet përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi.

KREU VIII
DISPOZITA TË FUNDIT

1. Udhëzimi nr. 41, datë 8.12.2009, "Për procedurat e njohjes zyrtare dhe njësimit të diplomave dhe certifikatave të lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë", i ndryshuar, shfuqizohet.

2. Ngarkohet për zbatim të këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Shkencës dhe komisionet përkatëse.

Ky udhëzim hyn fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT
Lindita Nikolla

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

Komisioni i Njohjes së Diplomave

Nr. Regjistrit _____ Tiranë, më __.__.____

VËRTETIM NJOHJEJE DHE NJËSIMI

Vërtetohet njohja e diplomës/certifikatës së Z/Znj. _____(Emër Mbiemër), lëshuar nga _____(institucioni që ka lëshuar diplomën/certifikatën), _____(shteti), me program ____vjeçar (kohëzgjatja e programit), ____ECTS (numri i krediteve të fituara në rast kur këto disponohen), në _____(emërtimi i programit të studimit).

Kjo diplomë/certifikatë njësohet si _____në Republikën e Shqipërisë.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

(Emër Mbiemër)
(Nënshkrimi)

KRYETAR I KOMISIONIT

(Emër Mbiemër)
(Nënshkrimi)

(Vula e institucionit)

Shënim: Ky vërtetim njohjeje është i vlefshëm kur shoqërohet me diplomën/certifikatës e huaj dhe është i vlefshëm vetëm në Republikën e Shqipërisë.

UDHËZIM
Nr. 18, datë 11.8.2016

PËR PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE TË REGJISTRIMIT TË KANDIDATËVE NGA REPUBLIKA E KOSOVËS, KANDIDATËVE ME ORIGJINË SHQIPTARE NGA MAQEDONIA, MALI I ZI, PRESHEVA, MEDVEGJA DHE BUJANOVCI, SI DHE KANDIDATËVE ME STATUSIN E TË VERBRIT, INVALIDIT PARAPLEGJIK DHE TETRAPLEGJIK, E JETIMIT, SI DHE ROMËT DHE EGJIPTIANËT, NË PROGRAMET E CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE, NË PROGRAMET E STUDIMEVE ME KARAKTER PROFESIONAL, SI DHE NË PROGRAMET E INTEGRUARA TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË, ME KOHË TË PLOTË, NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË, PËR VITIN AKADEMIK 2016–2017"

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të ligjit nr. 80/2015, datë 22.7.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", të ligjit nr. 93/2014, datë 24.7.2014, "Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara", të ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994, "Për statusin e invalidit", të ndryshuar, të ligjit nr. 8153, datë 31.10.1996, "Për statusin e jetimit", të ndryshuar, të ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996, "Për statusin e të verbrit", të ndryshuar, të ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000, "Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik", të ndryshuar, të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar, si dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 407, datë 1.6.2016, "Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2016–2017",

UDHËZOJ:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Kandidatët nga Republika e Kosovës, kandidatët me origjinë shqiptare nga Maqedonia, Mali i Zi, Presheva, Bujanovci dhe Medvegja, si dhe kandidatët me statusin e të verbrit, invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik, e jetimit, romët dhe egjiptianët, aplikojnë pranë institucioneve të arsimit të lartë (IAL), nga data 12–19 gusht 2016 në programet e studimit ku janë parashikuar kuotat përkatëse nga IAL-ja. Kuotat e parashikuara për kandidatët me statusin e të verbrit, invalidit tetraplegjik dhe paraplegjik, të paplotësuara janë të hapura për aplikimin për të gjithë kategorinë e kandidatëve, persona me aftësi të kufizuara.

2. Kandidatët që aplikojnë në programe studimi për të cilat është parashikuar konkurs pranimi, aplikojnë pranë IAL-ve respektive, deri në datën 24 gusht 2016. Në të njëjtën datë, IAL-të shpallin listën e kandidatëve që do të marrin pjesë në konkurs, e cila bëhet publike në mjediset e IAL-ve dhe faqet elektronike zyrtare. Konkurset e pranimit zhvillohen nga data 25–30 gusht 2016.

3. Aplikimi të kryhet vetëm nga kandidatët që kanë përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm dhe që plotësojnë kriterin e mesatares të përcaktuar në vendimin nr. 407, datë 1.6.2016, "Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2016–2017", si dhe plotësojnë kriteret e pranimit të vendosura nga vetë IAL-të për programet e studimit për të cilat aplikojnë. Përjashtohen nga kriteri i notës mesatare kandidatët që aplikojnë për ndjekjen e programeve të studimit me karakter profesional.

4. Kandidatët kanë të drejtë të aplikojnë deri në 10 programe studimi në një ose disa IAL.

KREU II
DOKUMENTACIONI I APLIKIMIT

1. Kandidatët nga Republika e Kosovës, si dhe kandidatët me origjinë shqiptare nga Maqedonia, Mali i Zi, Presheva, Bujanovci dhe Medvegja, si dhe kandidatët me statusin e të verbrit, invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik, e jetimit, romët dhe egjiptianët, në momentin e aplikimit duhet të dorëzojnë dokumentacionin e mëposhtëm:

1.1 Kandidatët nga Republika e Kosovës, si dhe kandidatët me origjinë shqiptare nga Maqedonia, Mali i Zi, Presheva, Bujanovci dhe Medvegja:

a) Formulari i aplikimit sipas formatit të shtojcës nr. 1.

b) Kopje të dokumentit të lëshuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, që vërteton se diploma e

arsimit të mesëm është në proces njohjeje, të shoqëruar me fotokopje të diplomës/dëftesës dhe listës së notave.

Në momentin e regjistrimit, kandidati fitues duhet të dorëzojë pranë IAL-ve, deklaratën bashkëlidhur këtij udhëzimi (shtojca 3), si dhe kopje të noterizuar në Republikën e Shqipërisë (dhe e përkthyer në gjuhën shqipe nëse është lëshuar në gjuhë të huaj), të diplomës së Maturës Shtetërore së bashku me certifikatën e notave ose diplomën/dëftesën e shkollës së mesme të fituar në vendin përkatës, së bashku me certifikatën e notave, të legalizuar nga autoritetet drejtuese, vendore apo qendrore, të vendit ku ka përfunduar studimet, si dhe dokumentin e njohjes në Republikën e Shqipërisë nga komisioni i posaçëm për njohjen e diplomave të arsimit të mesëm në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit. Në rast se kandidati/ja ka përfunduar shkollën e mesme në Shqipëri, dorëzon kopje të noterizuar të Maturës Shtetërore së bashku me certifikatën e notave;

c) Dokument identifikimi (kartë identiteti, pasaportë). Në dosje mbahet vetëm fotokopja e dokumentit të identifikimit;

d) Dy fotografi personale;

e) Kopje të mandatpagesës;

1.2 Kandidatët me statusin e të verbrit, invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik, e jetimit, romët dhe egjiptianët:

a) Formulari i aplikimit sipas formatit të shtojcës nr. 2, bashkëlidhur këtij udhëzimi;

b) Kopje të diplomës/dëftesës dhe listës së notave.

Në momentin e regjistrimit kandidati fitues duhet të dorëzojë pranë IAL-ve, deklaratën bashkëlidhur këtij udhëzimi (shtojca 3), si dhe kopje të njësuar me origjinalin të diplomës së Maturës Shtetërore së bashku me certifikatën e notave ose të një dëftese/diplome tjetër studimi të fituar jashtë vendit, të vlerësuar të barasvlershme me të në Shqipëri dhe të njohur nga Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS). Kandidati që ka përfunduar shkollën e mesme në Republikën e Shqipërisë përpara vitit 2011, të dorëzojë kopje të njësuar me origjinalin të dëftesës së pjekurisë së shkollës së mesme. Në mungesë të diplomës së Maturës Shtetërore apo dëftesës së pjekurisë së shkollës së mesme duhet të paraqesë, respektivisht, vërtetim notash të Maturës Shtetërore të lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Provimeve (AKP) ose dublikatë të dëftesës së pjekurisë të lëshuar nga drejtoria e shkollës së mesme dhe të vërtetuar në njësinë arsimore vendore (drejtorinë arsimore rajonale/zyra arsimore) përkatëse ose listën e notave të shkollës së mesme të lëshuar nga Arkivi i Shtetit;

c) Fotokopja e dokumentit të identifikimit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë);

d) Dy fotografi personale;

e) Kopje të mandatpagesës.

1.2.1 Kandidatët me statusin e të verbrit, përveç dokumentacionit të parashikuar në pikën 1.2 duhet të dorëzojnë dhe kopje të librezës së të verbrit të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror ose kopje të vendimit të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP).

1.2.2 Kandidatët me statusin invalidit paraplegjik e tetraplegjik, përveç dokumentacionit të parashikuar në pikën 1.2 duhet të dorëzojnë kopje të librezës të invalidit paraplegjik e tetraplegjik të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror ose kopje të vendimit të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP).

1.2.3 Kandidatët me statusin e jetimit, përveç dokumentacionit të parashikuar në pikën 1.2 duhet të dorëzojnë dhe kopje të dokumentit që certifikon statusin e jetimit të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror.

1.2.4 Kandidatët romë dhe egjiptianë, përveç dokumentacionit të parashikuar në pikën 1.2 duhet të dorëzojnë dhe vetëdeklarim ose një dokument që vërteton që është rom apo egjiptian.

Për përzgjedhjen e kandidatëve romë dhe egjiptianë, IAL-të marrin dhe ekspertizën e Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

1.2.5 Në rastet e aplikimeve nga kandidatët nga kategori të tjera të personave me aftësi të kufizuara, përveç dokumentacionit të parashikuar në pikën 1.2, duhet të dorëzojnë dhe kopje të vendimit të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP).

Në momentin e regjistrimit si kandidat fitues vendimi i Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë depozitohet si kopje e njësuar me origjinalin.

KREU III
PROCEDURA E APLIKIMIT,
PËRZGJEDHJES DHE REGJISTRIMIT

1. Kandidatët nga Republika e Kosovës, si dhe kandidatët me origjinë shqiptare nga Maqedonia, Mali i Zi, Presheva, Bujanovci dhe Medvegja, si dhe kandidatët me statusin e të verbrit, invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik, e jetimit, romët dhe egjiptianët përpara aplikimit, kryejnë pagesën e tarifës së aplikimit në vlerën 200 lekë për program studimi, në zyrat e Postës Shqiptare në llogari të çdo IAL-je pranë të cilit aplikon.

2. Aplikimi për programet e studimit në IAL dërgohet me postë pranë sekretarive mësimore ose depozitohet në zyrën e protokollit të njësive kryesore të IAL-ve.

3. Sekretaritë mësimore mbajnë regjistër për aplikimet e depozituara. Me depozitimin e aplikimit, njësitë kryesore përllogaritin mesatare për çdo kandidat në përputhje me vendimin nr. 407, datë 1.6.2016, "Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë në institucione të arsimit të lartë, për vitin akademik 2016–2017". Për kandidatët të cilët nuk plotësojnë kriterin e notës mesatare njoftohen nga sekretaritë mësimore për ndërprerjen e aplikimit.

4. IAL-të kryejnë procesin e përzgjedhjes së kandidatëve fitues në bazë të kritereve të përcaktuara nga ana e tyre. IAL-të, për çdo program studimi që ofrojnë, publikojnë listat e renditjes së kandidatëve dhe formulën/mënyrën e përzgjedhjes. IAL-të, në datën 5 shtator 2016, publikojnë në mjedise të dukshme dhe faqen e tyre zyrtare të internetit listën jopërfundimtare të fituesve të identifikuar me ID-në e kandidatit, duke respektuar përcaktimet e kuadrit ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale.

5. Kandidatët kanë të drejtën e ankimimit brenda tri ditëve kalendarike nga data e shpalljes së rezultateve. IAL-të detyrohen të shprehen me vendim të argumentuar lidhur me ankimimin brenda dy ditëve pune nga data e paraqitjes së ankesave. Vendimet e IAL-ve ankimohen në gjykatën kompetente.

6. IAL-të shpallin listat përfundimtare të kandidatëve fitues të identifikuar me ID-në e kandidatit, në faqet elektronike zyrtare dhe në mjediset e tyre, në datën 12 shtator 2016, duke respektuar përcaktimet e kuadrit ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale.

7. Kandidatët regjistrohen vetëm në njërin nga programet e studimit ku janë shpallur fitues brenda datës 19 shtator 2016. Regjistrimi i kryer konsiderohet përfundimtar dhe kandidati nuk mund të heqë dorë për t'u regjistruar në një program tjetër studimi.

8. Pas datës 19 shtator 2016, sekretaritë mësimore në njësitë kryesore të IAL-ve, për kuotat e paplotësuara, njoftojnë kandidatët të renditur sipas listës së shpallur, të cilët nuk janë regjistruar në një program tjetër studimi. Kandidatët e shpallur fitues dhe të regjistruar në një program tjetër studimi nuk ftohen për të plotësuar këto kuota.

9. IAL-të, brenda datës 6 tetor 2016 përfundojnë regjistrimin e të gjithë kandidatëve fitues.

10. IAL-të, brenda datës 7 tetor 2016, dërgojnë pranë Agjencisë Kombëtare të Provimeve dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit listën e studentëve të regjistruar, në formë shkresore dhe elektronike në format *Excel*, me qëllim pajisjen me numër matrikullimi. Për të gjithë emrat e studentëve të dërguar pas kësaj date nuk do të procedohet me dhënien e numrave të matrikullimit dhe do të kërkohet nga AKP-ja çregjistrimi i tyre.

11. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Shkencës në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencia Kombëtare e Provimeve dhe institucionet e arsimit të lartë.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT
Lindita Nikolla

Shtojca nr. 1

Tiranë, më _____._____.2016

Formular aplikimi

1. Unë i nënshkruari _____ , lindur më _____
emër, atësi, mbiemër

me kartë identiteti/pasaportë nr. _____

E-mail: _____, tel: _____

Kërkoj të regjistrohem në programin e studimit _____ në IAL _____.

1. Deklaroj se aplikoj me kuotat për kandidatët me kombësi shqiptare nga trojet (të shënohet me "x" vendi nga vjen kandidati):
□ Republika e Kosovës;
□ Mali i zi;
□ Maqedonia;
□ Presheva;
□ Bujanovci;
□ Medvegja;

2. Autorizoj institucionin e arsimit të lartë të sipërcituara dhe Agjencinë Kombëtare të Provimeve për trajtimin e të dhënave të mia personale në kuadër të aplikimit dhe regjistrimit për vazhdimin e studimeve universitare në institucionin e sipërcituar, si dhe publikimin e tyre.

3. Deklaroj se do të regjistrohem vetëm në një nga programet e studimit në të cilin do të shpallem fitues për vitin akademik 2016–2017.

4. Deklaroj se nuk po ndjek ndonjë program tjetër studimi në institucione të tjera të arsimit të lartë, dhe se nuk do të ndjek njëkohësisht një program tjetër studimi, deri në përfundimin e programit të studimit ku po aplikoj.

5. Deklaroj se jam njohur me udhëzimin përkatës dhe jam i qartë për procedurat e aplikimit, përzgjedhjes dhe regjistrimit.

6. Deklaroj vërtetësinë e të dhënave dhe të dokumenteve të paraqitura. Jam i vetëdijshëm se, në rast deklarimi të të dhënave të pavërteta apo të paraqitjes së dokumenteve të falsifikuara apo me të dhëna jo të vërteta, jam subjekt i masave të parashikuara në Kodin Penal dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi. Në rast dyshimi për vërtetësinë e informacionit të deklaruar, Agjencia Kombëtare e Provimeve dhe/ose IAL-ja nisin procedurën e kontrollit të tyre, duke ua përcjellë këto të dhëna eventualisht edhe organeve kompetente.

_____
Emër, atësi, mbiemër i kandidatit

Firma

Shtojca nr. 2

Tiranë, më _____._____.2016

Formular aplikimi

Unë i nënshkruari _____ , lindur më _____
emër, atësi, mbiemër

me kartë identiteti/pasaportë nr. _____

7. Kërkoj të regjistrohem në programin e studimit _____ në IAL _____.

8. Deklaroj se jam (të shënohet me "x" kategoria):

□ i/e verbër; □ jetim;

□ invalid paraplegjik/tetraplegjik; □ rom;

□ të tjerë (PAK); □ egjiptian.

9. Autorizoj institucionet e arsimit të lartë të sipërcituara dhe Agjencinë Kombëtare të Provimeve për trajtimin e të dhënave të mia personale në kuadër të aplikimit dhe regjistrimit për vazhdimin e studimeve universitare në institucionin e sipërcituar, si dhe publikimin e tyre.

10. Deklaroj se do të regjistrohem vetëm në një nga programet e studimit në të cilin do të shpallem fitues për vitin akademik 2016–2017.

11. Deklaroj se nuk po ndjek ndonjë program tjetër studimi në institucione të tjera të arsimit të lartë, dhe se nuk do të ndjek njëkohësisht një program tjetër studimi, deri në përfundimin e programit të studimit ku po aplikoj.

12. Deklaroj se jam njohur me udhëzimin "Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit të kandidatëve nga Republika e Kosovës, kandidatëve me origjinë shqiptare nga Maqedonia, Mali i Zi, Presheva, Medvegja dhe Bujanovci, si dhe kandidatëve me statusin e të verbrit, invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik, jetimit, romët dhe ballkano-egjiptianët, në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2016–2017" dhe jam i qartë për procedurat e aplikimit, përzgjedhjes dhe regjistrimit.

13. Deklaroj vërtetësinë e të dhënave dhe dokumenteve të paraqitura. Jam i vetëdijshëm se, në rast deklarimi të të dhënave të pavërteta apo të paraqitjes së dokumenteve të falsifikuara apo me të dhëna jo të vërteta, jam subjekt i masave të parashikuara në Kodin Penal dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi. Në rast dyshimi për vërtetësinë e informacionit të deklaruar, Agjencia Kombëtare e Provimeve dhe IAL-ja nisin procedurën e kontrollit të tyre duke ua përcjellë këto të dhëna eventualisht edhe organeve kompetente.

_____
Emër, atësi, mbiemër i kandidatit

Firma

Shtojca nr. 3

DEKLARATË

Unë i nënshkruari _____, lindur më _____,
me kartë identiteti, pasaportë nr. _____.

1. Autorizoj institucionin e arsimit të lartë _____, Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe Agjencinë Kombëtare të Provimeve, për trajtimin e të dhënave të mia personale në kuadër të aplikimit dhe regjistrimit për vazhdimin e studimeve universitare në institucionin e sipërcituar, si dhe publikimin eventual të tyre. Autorizoj, gjithashtu Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe Agjencinë Kombëtare të Provimeve, për kryerjen e të gjitha verifikimeve dhe marrjen e të gjitha informacioneve, lidhur me studimet universitare ku kam aplikuar për t'u regjistruar, periudhën e studimeve të kryera më parë dhe çdolloj verifikimi tjetër që lidhet me sa më sipër.

2. Deklaroj se do të regjistrohem vetëm në një nga programet e studimit në të cilin do të shpallem fitues për vitin akademik 2016–2017.

3. Deklaroj se nuk po ndjek ndonjë program tjetër studimi në institucione të tjera të arsimit të lartë, dhe se nuk do të ndjek njëkohësisht një program tjetër studimi, deri në përfundimin e programit të studimit ku po aplikoj.

4. Deklaroj vërtetësinë e të dhënave dhe dokumenteve të paraqitura. Jam i vetëdijshëm se, në rast deklarimi të të dhënave të pavërteta apo të paraqitjes së dokumenteve të falsifikuara apo me të dhëna jo të vërteta, jam subjekt i masave të parashikuara në Kodin Penal dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi. Në rast dyshimi për vërtetësinë e informacionit të deklaruar, Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe/ose Agjencia Kombëtare e Provimeve, dhe/ose IAL-ja nisin procedurën e kontrollit të tyre, duke ua përcjellë këto të dhëna eventualisht edhe organeve kompetente.

_____	_____
Emër, atësi, mbiemër i kandidatit	Emër, atësi, mbiemër i punonjësit të sekretarisë mësimore
Firma:	Firma:
Vendi: _____	Data: ____ . ____. ___

UDHËZIM
Nr. 19, datë 11.8.2016

PËR ZHVILLIMIN E PROVIMEVE KOMBËTARE TË ARSIMIT BAZË 2016, SESIONI I DYTË

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 26, 27 dhe 50, të ligjit nr. 69, datë 21.6.2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, vendimit të Këshillit Ministrave nr. 1013, datë 10.12.2010, "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve", si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 352, datë 3.4.2013, "Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror të Arsimit",

UDHËZOJ:

1. Zhvillimin e provimeve kombëtare të arsimit bazë 2016, sesioni i dytë, në datat si më poshtë vijon

a) Gjuhë e huaj: 25 gusht 2016
b) Gjuhë shqipe: 27 gusht 2016
b) Matematikë: 29 gusht 2016

2. Nxënësit e pakicave kombëtare (greke dhe maqedonase) të zhvillojnë provimin në lëndën Gjuhë amtare, sesioni i dytë, në datën 22 gusht 2016.

3. Për provimet kombëtare të arsimit bazë 2016, sesioni i dytë, të ndiqen procedurat e përcaktuara në urdhrin nr. 119, datë 20.3.2016, për miratimin e rregullores "Për procedurat e organizimit dhe të zhvillimit të provimeve kombëtare të arsimit bazë 2016"

4. Provimet kombëtare të arsimit bazë 2016, sesioni i dytë, përcaktuar në pikën 1 dhe 2 këtij udhëzimi, të fillojnë në orën 10:00 dhe të zgjasin 2 orë e 30 minuta.

5. Hartimi i testeve kryhet sipas rregullores për procesin e organizimit dhe të zhvillimit të provimeve kombëtare të arsimit bazë 2016.

6. Për shkollat e pakicës kombëtare greke, teza për provimin në lëndën Gjuhë amtare, sesioni i dytë, përgatitet nga DAR Gjirokastër. Zyra arsimore Delvinë dhe Zyra Arsimore Sarandë, tërheqin në DAR Gjirokastër tezën, ditën e provimit.

7. Për shkollat e pakicës kombëtare maqedonase, teza për provimin në lëndën Gjuhë amtare, sesioni i dytë, përgatitet nga DAR Korçë dhe tërhiqet ditën e provimit nga drejtori i shkollës, shoqëruar nga përfaqësuesi i DAR Korçë.

8. Arkivimi i testeve të bëhet pranë DAR/ZA-ve qendra.

9. Inspektorati Shtetëror i Arsimit monitoron procesin e provimeve kombëtare të arsimit bazë 2016, sesioni i dytë.

10. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi zëvendësministri i Arsimit dhe Sportit, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit Parauniversitar, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse, Agjencia Kombëtare e Provimeve, Inspektorati Shtetëror i Arsimit, drejtoritë arsimore rajonale dhe zyrat arsimore.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT
Lindita Nikolla

UDHËZIM
Nr. 20, datë 11.8.2016

PËR ZHVILLIMIN E PROVIMEVE TË MATURËS SHTETËRORE 2016, SESIONI I DYTË

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 26, 27, 30 dhe 51, të ligjit nr. 69/2012, datë 21.6.2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të ligjit nr. 80/2015, datë 22.7.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë",

UDHËZOJ:

KREU I
PROVIME TË MATURËS SHTETËRORE 2016, SESIONI I DYTË

1. Provimet e Maturës Shtetërore 2016, sesioni i dytë, të zhvillohen në datat e mëposhtme:

a) Gjuhë e huaj: 30 gusht 2016;

b) Gjuhë shqipe dhe letërsi: 2 shtator 2016;

c) Matematikë: 6 shtator 2016;

d) Lëndë me zgjedhje: 10 shtator 2016.

2. Për provimet e Maturës Shtetërore 2016, sesioni i dytë, të ndiqen procedurat e përcaktuara në urdhrin e MAS-it, nr. 91, datë 2.3.2016, "Për miratimin e Rregullores së Maturës Shtetërore 2016 në Republikën e Shqipërisë".

3. Hartimi i testeve të provimeve të Maturës Shtetërore 2016, sesioni i dytë, të kryhet sipas urdhrit të MAS-it nr. 91, datë 2.3.2016, "Për miratimin e Rregullores së Maturës Shtetërore 2016 në Republikën e Shqipërisë".

4. Provimet e Maturës Shtetërore 2016, sesioni i dytë, të fillojnë në orën 10:00.

5. Testi për secilin nga provimet e detyruara të përmbajë 25 pyetje, nga të cilat 13 pyetje të jenë me përgjigje alternative dhe të vlerësohen me 13 pikë, ndërsa 12 pyetje të jenë me zgjidhje dhe të vlerësohen me 37 pikë.

6. Provimet e lëndëve me detyrim të Maturës Shtetërore 2016 të zgjasin 2 orë e 30 minuta secili.

7. Testi i provimit të detyruar të gjuhës së huaj të hartohet nga AKP-ja dhe të administrohet nga DAR/ZA-ja.

8. Testi për secilin nga provimet me zgjedhje të përmbajë 20 pyetje, nga të cilat 10 pyetje të jenë me përgjigje alternative dhe të vlerësohen me 10 pikë, ndërsa 10 pyetje të jenë me zgjidhje dhe të vlerësohen me 30 pikë.

9. Provimet e lëndëve me zgjedhje të zgjasin 3 orë.

10. Maturantët që kanë vetëm një provim me zgjedhje, të hyjnë në provim në orën 11:00 dhe ta përfundojnë atë në orën 13:00.

11. Testi i provimit me zgjedhje të gjuhës së huaj Anglisht "TOEFL Junior Standard Test" hartohet dhe vlerësohet nga ETS Global, në bazë të marrëveshjes ndërmjet Education Testing Service Global BV dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

12. Provimi i gjuhës së huaj Anglisht "TOEFL Junior Standard Test" zgjat 1 orë e 55 minuta.

13. Maturantët/kandidatët që japin dy provime me zgjedhje, ku njëri prej tyre është gjuhë e huaj Anglisht "TOEFL Junior Standard Test", hyjnë në provimin tjetër me zgjedhje në orën 11:30. Provimin e gjuhës së huaj Anglisht "TOEFL Junior Standard Test" e japin në orën 13:30.

14. Kandidatët që japin provim me zgjedhje vetëm gjuhën e huaj Anglisht "TOEFL Junior Standard Test", hyjnë në provim në orën 13:30.

KREU II
MATURANTËT/KANDIDATËT QË DO TË MARRIN PJESË NË PROVIMET E MATURËS SHTETËRORE 2016, SESIONI I DYTË

1. Në provimet e Maturës Shtetërore 2016, sesioni i dytë, do të marrin pjesë:

a) Maturantët/kandidatët që rezultuan mbetës në një ose më shumë provime të Maturës Shtetërore 2016, sesioni i parë;

b) Maturantët që rezultuan mbetës në një ose dy lëndë në vitin shkollor 2015–2016 dhe i shlyejnë provimet shkollore në datat 22 dhe 23 gusht 2016;

c) Kandidatët që kanë përfunduar shkollën e mesme para vitit 2016, por që nuk kanë shlyer detyrimet e Maturës Shtetërore;

d) Kandidatët që kanë përfunduar shkollën e mesme jashtë vendit dhe kanë njësuar dokumentet shkollore në Komisionin e Posaçëm në MAS, të ngritur me urdhrin nr. 165, datë 8.4.2016, "Për ngritjen e komisionit të posaçëm për procedurat e njëvlershmërisë së dëftesave/diplomave të shkollave të mesme të shtetasve shqiptarë dhe të huaj, që kanë kryer arsimin e mesëm jashtë shtetit", por që duhet të japin një apo dy provime me zgjedhje.

2. Maturantët/kandidatët e përcaktuar në pikën 1/a, b të plotësojnë formularin Al për dhënien e provimeve të sesionit të dytë të Maturës Shtetërore.

3. Kandidatët/kandidatët e përcaktuar në pikën 1/c, d të regjistrohen në shkollën ku kanë përfunduar arsimin e mesëm ose në shkollën që u cakton DAR/ZA-ja e vendbanimit të tyre. Këta kandidatë të plotësojnë formularin A1Z, në datat 22 deri 24 gusht 2016.

4. Drejtori i shkollës të dërgojë zyrtarisht në DAR/ZA listën e kandidatëve që do të marrin pjesë në provimet e Maturës Shtetërore 2016, sesioni i dytë, në datën 24 gusht 2016. Drejtori i DAR/ZA-së ta dërgojë këtë listë në AKP, në datën 25 gusht 2016.

KREU III
ADMINISTRIMI I PROVIMEVE

1. Provimet të zhvillohen të përqendruara në drejtoritë arsimore rajonale. ZA Tropojë, ZA Lushnjë dhe ZA Sarandë t'i zhvillojnë provimet në qytetet e tyre. ZA Delvinë t'i zhvillojë provimet në qytetin e Sarandës.

2. Drejtoritë arsimore rajonale dhe drejtoritë e shkollave të marrin masa për njoftimin e maturantëve/kandidatëve për datat, mjedisin dhe orën kur do të zhvillohet secili nga provimet e Maturës Shtetërore 2016, sesioni i dytë.

3. Drejtori i DAR/ZA-së, brenda datës 20 gusht 2016, të njoftojë zyrtarisht AKP-në për mjedisin ku do të zhvillohen provimet e Maturës Shtetërore 2016, sesioni i dytë.

4. Në DAR-et ku rezulton se numri i maturantëve/kandidatëve është më i madh se 500, të përdoren 2 mjedise.

5. Administrimi dhe zhvillimi i provimeve të Maturës Shtetërore 2016, sesioni i dytë, të bazohet në urdhrin e MAS-it nr. 91, datë 2.3.2016, "Për miratimin e Rregullores së Maturës Shtetërore 2016 në Republikën e Shqipërisë".

KREU IV
HARTIMI DHE VLERËSIMI I TESTEVE TË PROVIMEVE TË MATURËS SHTETËRORE 2016, SESIONI I DYTË

1. Pas zhvillimit të çdo provimi të Maturës Shtetërore 2016, sesioni i dytë, testet e maturantëve/kandidatëve të dërgohen në AKP, sipas procedurave të përcaktuara në urdhrin e MAS-it nr. 91, datë 2.3.2016, "Për miratimin e rregullores së Maturës Shtetërore 2016 në Republikën e Shqipërisë".

2. Vlerësimi i testeve të Maturës Shtetërore 2016, sesioni i dytë, të ndjekë procedurat e përcaktuara në urdhrin e MAS-it nr. 91, datë 2.3.2016, "Për miratimin e Rregullores së Maturës Shtetërore 2016 në Republikën e Shqipërisë".

3. Monitorimi dhe administrimi i procesit të Maturës Shtetërore 2016, sesioni i dytë, të kryhet nga përfaqësuesit e MAS-it dhe institucionet e varësisë, të cilët raportojnë në DAPU për çdo parregullsi të vërejtur.

4. Në përfundim të çdo provimi, përfaqësuesit e MAS-it dhe institucioneve të vartësisë të dorëzojnë raportin për monitorimin e provimit.

5. Përfaqësuesit e MAS-it dhe të institucioneve të vartësisë të ushtrojnë funksionin e tyre me autorizim të ministrit të Arsimit dhe Sportit.

6. Të gjitha shpenzimet e përfaqësuesve të MAS-it, gjatë provimeve të Maturës Shtetërore 2016, sesioni i dytë, të përballohen nga institucionet përkatëse, ku kanë qendrën e punës, sipas dispozitave në fuqi.

7. Ngarkohen, për zbatimin e këtij udhëzimi, zëvendësministri i Arsimit dhe Sportit, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit Parauniversitar, Drejtoria e Financave, AKP-ja, ISHA-ja, IZHA-ja, APAAL-ja, AKAFPK-ja, drejtoritë arsimore rajonale dhe zyrat arsimore.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT
Lindita Nikolla

UDHËZIM
Nr. 21, datë 18.8.2016

PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E GJIMNAZIT ME KOHË TË PJESSHME

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 26, pika 2/a, nenit 16, germa "b" dhe nenit 24, pika 2, të ligjit nr. 69/2012, datë 21.6.2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

UDHËZOJ:

Neni 1
Organizimi i gjimnazit me kohë të pjesshme

1. Gjimnazi me kohë të pjesshme (GJKP), organizohet në çdo njësi arsimore vendore, e cila, me vendim të posaçëm, cakton 1 (një) institucion arsimor që ofron gjimnazin me kohë të pjesshme.

2. Gjimnazi me kohë të pjesshme zgjat 4 (katër) vite shkollimi dhe funksionon me tri ditë në javë.

3. Gjimnazi me kohë të pjesshme funksionon në qytetin qendër të njësisë arsimore vendore.

4. Gjimnazi me kohë të pjesshme funksionon si institucion arsimor i veçantë, kur numri i nxënësve të regjistruar është mbi 300.

5. Kur GJKP-ja funksionon në një gjimnaz me kohë të plotë, drejtoria e shkollës krijon dokumentacion shkollor të veçantë (amzë, indeks amze dhe regjistër klase) për dokumentimin e realizimit të procesit mësimor.

6. Plani mësimor dhe udhëzimi për zbatimin e programeve lëndore të GJKP-së, hartohen nga IZHA-ja dhe miratohen nga ministri i Arsimit dhe Sportit.

7. Ngarkesa mësimore e mësuesve dhe numri i nxënësve për klasë rregullohet sipas akteve nënligjore në fuqi.

Neni 2
E drejta për të ndjekur gjimnazin me kohë të pjesshme

Nxënësi që ka mbushur moshën njëzet e një vjeç dhe nuk e ka përfunduar gjimnazin, ka të drejtë të vijojë gjimnazin me kohë të pjesshme.

Neni 3
Kritere dhe procedura të regjistrimit në klasën e 10-të të gjimnazit me kohë të pjesshme

Nxënësi që ka dëftesën e lirimit, të fituar brenda vendit ose një dëftesë të njëvlershme me të, të fituar jashtë vendit, dhe plotëson kriterin e moshës, të përcaktuar në nenin 2 të këtij udhëzimi, ka të drejtë të regjistrohet në klasën e dhjetë të gjimnazit me kohë të pjesshme.

Neni 4
Regjistrimi në klasa të ndërmjetme të gjimnazit me kohë të pjesshme

1. Nxënësi që ka fituar dëftesën e klasës së dhjetë të gjimnazit me kohë të plotë brenda vendit, ka të drejtë të regjistrohet në klasën e njëmbëdhjetë të gjimnazit me kohë të pjesshme.

2. Nxënësi që ka përfunduar klasën e njëmbëdhjetë të gjimnazit me kohë të plotë brenda vendit, ka të drejtë të regjistrohet në klasën e trembëdhjetë të gjimnazit me kohë të pjesshme, nëse do të rezultojë kalues në provimet që duhet të japë për klasën e 12-të. Për lëndët mësimore të klasës së 12-të do t'i barten rezultatet e klasës së 11-të gjimnazit me kohë të plotë. Nxënësi do t'i japë provim lëndët e tjera të planit mësimor të klasës së 12-të me kohë të pjesshme.

3. Nxënësi që ka fituar dëftesën e klasës së 10-të dhe/ose të 11-të të gjimnazit me kohë të plotë, (sistemi 4-vjeçar), regjistrohet në klasën e 11-të,

përkatësisht të 12-të të gjimnazit me kohë të pjesshme, nëse rezulton kalues në provimet e lëndëve të munguara nga plani mësimor i GJKP-së.

4. Nxënësi që ka fituar dëftesën e klasës së 10-të të arsimit të mesëm profesional, regjistrohet në klasën e 11-të të GJKP-së, nëse rezulton kalues në provimet e lëndëve të munguara të planit mësimor të klasës së 10-të të GJKP-së. Vendimi për numrin e lëndëve të munguara, për të cilat duhet të merret në provim nxënësi, merret nga drejtoria e shkollës.

5. Provimet që organizon gjimnazi me kohë të pjesshme për regjistrimin/et në klasat e ndërmjetme, zhvillohen në shkollë brenda muajit shtator.

Neni 5

Dokumente për regjistrimin në gjimnazin me kohë të pjesshme

1. Për t'u regjistruar në klasën e dhjetë të gjimnazit me kohë të pjesshme, nxënësi duhet të paraqesë në institucionin shkollor (GJKP) dokumentet e mëposhtme:

a) kopjen e dokumentit të identifikimit;

b) dëftesën e lirimit ose, në mungesë të saj, vërtetimin origjinal me nota dhe me fotografi, lëshuar nga drejtori i shkollës dhe konfirmuar nga DAR/ZA-ja, ose kopjen e faqes së plotë të amzës, lëshuar nga zyra e Arkivit të Shtetit.

2. Për t'u regjistruar në klasën e ndërmjetme të gjimnazit me kohë të pjesshme, nxënësi duhet të paraqesë në institucionin shkollor (GJKP) dokumentet e mëposhtme:

a) kopjen e dokumentit të identifikimit;

b) dëftesën/at e përfundimit të klasës/ave paraardhëse ose, në mungesë, vërtetimin origjinal me nota dhe me fotografi, lëshuar nga drejtori i shkollës dhe konfirmuar nga DAR/ZA-ja përkatëse.

3. Regjistrimi i nxënësve, në të gjitha klasat e gjimnazit me kohë të pjesshme, realizohet në shkollë deri 1 (një) ditë para fillimit të vitit shkollor. Rastet e veçanta të regjistrimit përtej këtij afati, bëhen me vendim të arsyetuar të njësisë arsimore vendore.

Neni 6

Vlerësimi i nxënësve

1. Vlerësimi i arritjeve të nxënësve në gjimnazin me kohë pjesshme realizohet sipas formave dhe metodologjive që zbatohen për vlerësimin e arritjeve të nxënësve në gjimnazin me kohë të plotë.

2. Nxënësit e klasës së 10-të, të vitit shkollor 2016–2017, vlerësohen sipas metodologjisë së vlerësimit të përcaktuar në udhëzimin e MAS-it nr. 14, datë 28.7.2016, "Për vlerësimin e nxënësve në arsimin e mesëm të lartë".

3. Provimet për efekt të njëvlershmërisë zhvillohen vetëm me shkrim. Hartimi dhe vlerësimi i tyre bëhet nga komisionet lëndore, të miratuara me vendim të drejtorisë së shkollës.

4. Provimet me shkrim që zhvillohen në gjimnazin me kohë të pjesshme, monitorohen në çdo fazë nga njësia arsimore vendore.

5. Provimet e nxënësve ruhen sipas akteve nënligjore në fuqi dhe janë objekt i inspektimit.

Neni 7

Frekuentimi i nxënësve

Nxënësi që mungon më shumë se:

1. Nxënësi që mungon më shumë se 50% të orëve mësimore vjetore të një lënde, klasifikohet pakalues në atë lëndë.

2. Nxënësi që mungon më shumë se 30% të orëve vjetore të planit mësimor, mbetet në klasë.

3. Nxënësi që mungon deri në 50% të orëve mësimore vjetore të një lënde, merret në provim me shkrim nga mësuesi i lëndës për temat e programit mësimor që ka munguar. Notat e çdo provimi vendosen në shtylla të veçanta të regjistrit dhe u takojnë notave për kapitull/kapituj.

4. Datat e provimeve, për detyrimin sipas pikës 3 të këtij neni, caktohen nga mësuesi i lëndës dhe miratohen nga drejtori i shkollës.

Neni 8

Kurrikula e gjimnazit me kohë të pjesshme

1. Plani mësimor i GJKP-së nr. 7380 prot., datë 20.7.2016, i miratuar nga MAS-i, fillon zbatimin në klasën e 10-të të vitit shkollor 2016–2017.

2. IZHA-ja harton udhëzimin për zbatimin e programeve lëndore të GJKP-së, bazuar në programet lëndore të gjimnazit me kohë të plotë.

Neni 9

Detyra të njësive arsimore vendore

Njësia arsimore vendore mbështet cilësinë e shërbimit arsimor, të ofruar në gjimnazin me kohë të pjesshme, si dhe kryen këto detyra:

a) përcakton gjimnazin me kohë të pjesshme;

b) miraton ditët e javës për zhvillimin e mësimit sipas propozimit të drejtorit të gjimnazit përkatës;

c) kryen njëvlershmërinë e dokumentacionit të nxënësve që vijnë nga jashtë vendit;

d) monitoron procedurat e regjistrimit, të frekuentimit dhe procesin mësimor në tërësi.

Neni 10
Dispozita të fundit

1. Udhëzimi "Për organizimin dhe funksionimin e gjimnazit me kohë të pjesshme" fillon zbatimin në klasën e 10-të, viti shkollor 2016–2017.

2. Ngarkohen, për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit Parauniversitar, Inspektorati Shtetëror i Arsimit, Instituti i Zhvillimit të Arsimit, njësitë arsimore vendore dhe institucionet shkollore.

3. Udhëzimi i MASH-it nr. 23, datë 2.8.2013, "Për ndjekjen e gjimnazit me kohë të pjesshme", shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi në vitin shkollor 2016–2017 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT
Lindita Nikolla

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2016

Adresa:
Bulevardi "Gjergj Fishta"
pas ish-Ekspozitës"Shqipëria Sot"
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 252 lekë